

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
FAZA E POLITIKËS/E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Në Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Programi Qeverisës 2021-2025; Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	24.01.2025 – 21.02.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	4 Mars 2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 12.02.2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 – MSHSKB – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL-I, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Iris.Ago@sipermarrja.gov.al
PJESA 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (Jo më shumë se 10 rreshta)</i>	
Në një ekonomi në zhvillim si ajo e Shqipërisë, qasja në financa mbetet një sfidë thelbësore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomisë. Bazuar në analizat e Qeverisë Shqiptare dhe studimet e Bankës Botërore, krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) paraqitet si një hap i domosdoshëm për të adresuar boshllëqet në financim dhe për të mbështetur sektorët e nënfinancuar të ekonomisë. Një raport i detajuar i Bankës Botërore për Shqipërinë thekson disa sfida kryesore që dëshmojnë nevojën për një institucion të tillë. Së pari, financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) mbetet një prej sfidave më të mëdha. Shqipëria renditet me nivelin më të ulët të financimit për NVM-të në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Një analizë tregon se boshllëku financiar, i cili përfaqëson diferencën midis kërkesës dhe ofertës së kredive për NVM-të, arrin në 9.4% të PBB-së, ose rreth 1 miliard USD. Bankat tregtare në vend janë të orientuara kryesisht drejt sektorëve me rrezik të ulët, si pasuritë e paluajtshme dhe investimet në letra me vlerë, duke lënë mënjanë bizneset inovative dhe startup-et, të cilat kanë potencial të lartë për rritje ekonomike. Së dyti, sektori i bujqësisë, që përfaqëson rreth 16 - 19% të PBB-së, përfiton vetëm rreth 6% të kredive bankare, çka tregon mungesën e financimit të dedikuar. Ky hendek ka penguar modernizimin e bujqësisë dhe rritjen e produktivitetit, duke ndikuar negativisht në zhvillimin	

ekonomik të qëndrueshëm. Një bankë zhvillimi mund të luajë një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e kësaj problematike duke ofruar garanci kredie, linja të posaçme financimi dhe instrumente të tjera që lehtësojnë aksesin e fermerëve në financim.

Së fundi, financimi i infrastrukturës dhe projekteve publike përbën një tjetër sfidë kyçe. Raportet tregojnë se shumë projekte publike, për shkak të rreziqeve rregullatore, politike dhe natyrës së kthimeve afatgjata, nuk janë tërheqëse për investitorët privatë. Në këtë drejtim, një institucion si BZH mund të ofrojë garanci financiare dhe hua për të mbështetur projekte strategjike, si ndërtimi i infrastrukturës rrugore, investimet në energji të rinovueshme dhe transformimi digjital.

Krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit do të adresonte këto sfida duke përmirësuar qasjen në financim për sektorët strategjikë dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik të vendit në mënyrë të qëndrueshme dhe të balancuar.

OBJEKTIVAT

Cilët janë objektivat dhe efektet e synuar të propozimit?

Objektivi kryesor i politikës për krijimin e BZH është adresimi i sfidave të mungesës së financimit për sektorët strategjikë dhe përmirësimi i aksesit në kapital për bizneset shqiptare.

Ky objektivi i përgjithshëm mbështet një sërë synimesh specifike që lidhen drejtpërdrejt me problemet dhe boshllëqet e identifikuar në tregun financiar shqiptar, në përputhje me vizionin strategjik të qeverisë për zhvillimin ekonomik dhe integrimin në tregjet ndërkombëtare.

- Krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të specializuar për financimin e zhvillimit
- Mbështetja e NVM-ve dhe startup-eve për të përmirësuar aksesin në financim
- Ofrimi i kredidhënies së lehtësuar për sektorët prioritarë dhe lehtësimi i aksesit në fondet ndërkombëtare, brenda vitit 2027.
- Ndërtimi i një strukture financiare që mobilizon kapitalin privat dhe fondet ndërkombëtare për investime afatgjata në sektorë strategjikë, brenda vitit 2028
- Harmonizimi me praktikat më të mira evropiane në ndërtimin e një institucioni të besueshëm financiar;
- Rritja e kredive të garantuara të BZH me 2.2 % brenda vitit 2027 në 9% brenda vitit 2030

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krabasimin e avantazheve/të përfitimeve kryesore dhe të dezavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për të adresuar problematikat e identifikuar dhe për të përmbushur objektivat strategjike janë marrë në konsideratë disa opsione për të realizuar politikat e ndërmarra të Qeverisë Shqiptare:

Opsioni i Status Quo-së: Vazhdimi me kuadrin aktual rregullator pa ndryshime, do të mbajë në fuqi problematikat ekzistuese si boshllëqet e tregut dhe nënfinancimi.

Opsioni 1 – Forcimi i skemave ekzistuese të mbështetjes financiare (jo-rregullator): Ky opsion parashikon përmirësimin dhe zgjerimin e mekanizmave ekzistues të financimit, përfshirë skemat e garancive sovraane dhe grantet e dedikuara për sektorë të veçantë. Përparësitë kryesore të kësaj qasjeje përfshijnë shmangien e krijimit të një institucioni të ri dhe një kosto më të ulët

fillestare për qeverinë, pasi mbështetet në strukturat ekzistuese. Megjithatë, ky opsion ka disa kufizime të rëndësishme, përfshirë mungesën e një mekanizmi të qëndrueshëm afatgjatë, pamundësinë për të dhënë kredi direkte dhe fragmentimin e burimeve financiare. Për më tepër, efektiviteti i tij mbetet i kufizuar, pasi financimi do të vijojë të mbetet i varur nga fondet publike dhe donatorët ndërkombëtarë, duke mos siguruar një strukturë të pavarur dhe të vetëqëndrueshme.

Opsioni 2: Propozimi i një ligji të ri për Bankën e Zhvillimit: Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri për krijimin e Bankës së Zhvillimit si një institucion financiar dedikuar mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkurrues të vendit. Në thelbin e saj, BZH themelohet për të ndihmuar ndërmarrjet shqiptare që përballen me mungesë aksesit në financim nga tregu tradicional. Kjo mbështetje është veçanërisht e rëndësishme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe për startup-et, të cilat shpesh hasin vështirësi në sigurimin e kredive apo investimeve për zgjerim dhe inovacion. Përmes financimit të tyre, këto biznese mund të rrisin produktivitetin dhe të jenë më konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Një tjetër funksion kyç i BZH është promovimi i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve shqiptare. Duke nxitur tregtinë ndërkombëtare, institucioni kontribuon në zgjerimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Gjithashtu, një fokus i veçantë i BZH është përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe digjitale të vendit, duke krijuar një bazë të fortë për zhvillim afatgjatë.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimi mbi buxhetin shtetëror

BZH parashikon një kapital fillestar prej 10 miliardë lekësh, i cili do të sigurohet fillimisht nga buxheti i shtetit. Ky investim synon të gjenerojë një multiplikator ekonomik, duke mobilizuar kapital privat dhe duke krijuar mundësi më të mëdha financimi për bizneset.

Produktet dhe aktivitetet e biznesit

- BZH nuk parashikon aktivitet kreditimi në vitin 2025.
- BZH do të ofrojë huadhënie indirekte në vitin 2026, përmes marrëveshjeve për ndarjen e riskut ose garancive individuale për bankat
- BZH do të nisë huadhënien direkte në gjysmën e dytë të vitit 2027
- Ligji i ri për BZH synon të rrisë qëndrueshmërinë financiare, të modernizojë ekonominë dhe të tërheqë investime private e ndërkombëtare.

Me një strategji të qartë të huadhënies dhe garantimit të kredive, BZH do të shërbejë si një instrument kyç për mbështetjen e sektorëve strategjikë dhe për zhvillimin afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 2 i preferuar, që përfshin hartimin e një ligji të ri për BZH, është zgjedhur sepse ofron një zgjidhje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke adresuar boshllëqet e sistemit aktual dhe duke krijuar një mekanizëm të fuqishëm për zhvillimin ekonomik dhe mbështetjen e biznesit vendas.

Përfitimet kyçe të këtij opsioni përfshijnë:

- Krijimin e një strukture të qartë dhe transparente për financimin dhe garantimin e projekteve strategjike.
- Harmonizimin me standardet ndërkombëtare, duke e pozicionuar Shqipërinë më mirë në tregjet globale dhe duke lehtësuar aksesin në financime ndërkombëtare.
- Mbështetjen për ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe startup-et, duke lehtësuar aksesin në kredi dhe investime.
- Promovimin e rritjes ekonomike dhe stabilitetit financiar afatgjatë, duke siguruar fonde të dedikuara për projekte zhvillimore.
- Kostoja dhe përfitimi ekonomik
- Mbështetja nga buxheti i shtetit për këtë nismë është e vlerësuar në 10 miliardë Lekë, e shpërndarë në këste gjatë periudhës 2025-2027.
- Përfitimet afatgjata tejkalojnë ndjeshëm kostot, pasi BZH do të mundësojë mobilizimin e kapitalit privat, rritjen e investimeve dhe zgjerimin e mundësive për sektorët strategjikë.
- Efekti shumëfishues ekonomik do të rrisë konkurrencën e bizneseve shqiptare dhe do të forcojë tregjet financiare, duke e bërë këtë një investim strategjik për të ardhmen ekonomike të vendit.

Ky option siguron një bazë të qëndrueshme financiare për zhvillimin afatgjatë të ekonomisë shqiptare dhe krijon një instrument efikas për mbështetjen e sektorëve kyç.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 4-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):

BZH do të kërkojë një mbështetje financiare totale prej 10 miliardë lekë nga buxheti i shtetit, e cila do të shpërndahet në këste përgjatë një periudhe 4-vjeçare pas miratimit të ligjit. Këto fonde do të sigurojnë kapitalin fillestar të BZH dhe do të mundësojnë, fillimin e aktivitetit të BZH, zbatimin e skemave të financimit dhe garantimit, në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik dhe mbështetjes për bizneset.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?

Konsultimet paraprake mbi projektaktin kanë zgjatur një muaj. Konsultimet në portalin e Regjistrat Elektronik janë zhvilluar për një periudhë prej 20 ditësh pune, nga data 24 janar 2025 deri më 21 shkurt 2025. Gjatë kësaj kohe, portali ka regjistruar 963 vizita dhe është marrë një koment.

Procesi i konsultimit publik është realizuar përmes disa metodave. Projektligji dhe relacioni shpjegues janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, duke i mundësuar çdo të interesuari aksesin në dokumentet përkatëse. Dokumentet janë dërguar zyrtarisht pranë institucioneve relevante. Gjithashtu, janë zhvilluar konsultime të brendshme me institucionet që kanë kompetenca në fushën e prekur nga projektligji, si dhe me dhomat e biznesit, institucionet financiare të pranishme në vend dhe Shoqatën e Bankave.

Projektakti është përcjellë për shqyrtim dhe komente pranë institucioneve përkatëse, përfshirë Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit,

Departamentin e Administratës Publike, SASPAC, Postën Shqiptare Sha, Agjencinë e Prokurimit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

Në kuadër të konsultimeve publike për projektligjin “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”, u organizuan tre takime në ambientet e Shtëpisë së Biznesit, me pjesëmarrjen e aktorëve kyç të sektorit financiar dhe ekonomik.

- Më 5 shkurt 2025, u zhvillua një takim me Institucionet Financiare Ndërkombëtare, ku morën pjesë përfaqësues nga Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe institucione të tjera me interes për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Diskutimet u fokusuan në standardet ndërkombëtare për bankat zhvillimore dhe integrimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit në këtë ekosistem.
- Më 6 shkurt 2025, u mbajt një takim me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë si dhe Shoqatat e Biznesit. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e bankës si një institucion mbështetës për bizneset, pa krijuar konkurrencë të padrejtë me institucionet ekzistuese financiare.
- Më 7 shkurt 2025, u zhvillua një takim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, Shoqatën e Mikrokredisë dhe përfaqësues të sektorit bankar dhe mikrofinancës. Diskutimet u përqendruan në ndikimin e mundshëm të bankës në ekosistemin financiar, mekanizmat e bashkëpunimit me bankat tregtare dhe sigurimin e konkurrencës së ndershme.

Komentet dhe Sugjerimet Kryesore

- Transparencë dhe Qeverisje – Nevoja për qeverisje të mirë dhe mekanizma të qarta mbikëqyrjeje për të siguruar transparencë dhe shmangur ndikimet politike në aktivitetin e bankës.
- Roli Plotësues i Bankës – Banka e Zhvillimit duhet të ketë një funksion plotësues dhe jo konkurrues ndaj bankave tregtare, duke siguruar financime për sektorët e nënfinancuar dhe projektet strategjike.
- Mbikëqyrja nga Banka e Shqipërisë – Kërkohej një mekanizëm mbikëqyrjeje efektiv për të garantuar qëndrueshmërinë financiare të bankës dhe përputhshmërinë e saj me praktikën më të mirë ndërkombëtare.
- Kriteret e Financimit – Bizneset kërkuan kriteret të qarta dhe fleksibël për financimin e SME-ve dhe startupeve, duke siguruar qasje të barabartë në financime.
- Mekanizmi i Garancisë – U propozua krijimi i një instrumenti garancie për kreditimin e bizneseve të vogla, duke minimizuar rrezikun dhe lehtësuar aksesin në financa.
- Neutraliteti i Bankës – Shoqatat e biznesit theksuan se banka nuk duhet të krijojë avantazhe të padrejta për disa sektorë, por të mbështesë të gjithë aktorët ekonomikë në mënyrë të barabartë.
- Përdorimi i Kursimeve Postare – Bankat tregtare shprehën shqetësimin për përdorimin e kursimeve postare si burim financimi, duke argumentuar se kjo mund të krijojë konkurrencë të padrejtë në tregun bankar.
- Marrëdhënia me Sektorin Privat – U kërkuar qartësi mbi marrëdhënien e Bankës së Zhvillimit me sektorin privat, për të siguruar që ajo do të veprojë si një partner mbështetës dhe jo si një zëvendësues i bankave tregtare.

Adresimi i komenteve

Çështjet e transparencës në qeverisje, rolit plotësues të bankës, mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë, bashkëfinancimit me bankat tregtare, si dhe kufizimet mbi mbledhjen dhe përdorimin e fondeve, janë adresuar në ligj dhe do të elaborohen më tej në aktet nënligjore.

Komentet dhe sugjerimet e ngritura gjatë konsultimeve publike janë marrë me seriozitet të lartë dhe kanë ndihmuar në forcimin e rregullimit ligjor të Bankës së Zhvillimit. Bankat tregtare, së bashku me institucionet ndërkombëtare financiare, konsiderohen si partnerë strategjikë të Bankës Shqiptare të Zhvillimit, duke garantuar një ekosistem financiar të qëndrueshëm dhe efikas.

Komentet e marra nga institucionet përkatëse janë adresuar në projektligjin e ndryshuar dhe në relacionin shpjegues, në përputhje me kërkesat e institucionit komentues.

Për sa i takon komenteve ne faqen e konsultimit publik adresimi është si vijon:

Komentet e z. Eduart Gjokutaj, dërguar në portalin elektronik të konsultimit publik RENJKP

Projektligji për Bankën Shqiptare të Zhvillimit sjell një iniciativë të rëndësishme për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimin e aksesit në financa. Megjithatë, për të siguruar funksionimin e saj efikas dhe shmangien e ndikimeve negative në treg, nevojiten disa përmirësime përmbledhëse si më poshtë dhe të trajtuara më në detaje në vijimësi:

1. Rritja e transparencës dhe ndarjes mes aktiviteteve promovuese dhe tregtare për të shmangur konkurrencën e padrejtë me bankat tregtare.
2. Saktësimi i kriterëve për përzgjedhjen dhe monitorimin e drejtuesve për të siguruar qeverisje të mirë dhe shmangur ndikimet politike.
3. Rishikimi i politikës fiskale dhe garancive financiare, për të siguruar që kapitali publik të përdoret me efikasitet dhe të mos krijohen avantazhe të padrejta në treg.
4. Përforcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe raportimit financiar, duke siguruar transparencë në përdorimin e fondeve dhe në ndikimin e bankës në ekonomi.

Për të dhënë një analizë kritike të Projektligjit për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH), do të vlerësojmë dispozitat kyçe sipas neneve të propozuara, duke shqyrtuar përputhshmërinë me standardet ligjore, ndikimin në treg, rreziqet e mundshme dhe mundësitë për përmirësim.

Qëllimi dhe Objektivat (Nenet 1-2)

- Qëllimi i Projektligjit është i qartë dhe nxit zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor.
- Parashikimi i aktiviteteve promovuese dhe tregtare të BZH-së është pozitiv, por duhet të qartësohet më mirë ndarja mes tyre për të shmangur konfliktin e interesit dhe subvencionimin e ndërsjellë.
- Ndarja mes aktiviteteve promovuese dhe tregtare nuk është e qartë (Neni 2). Kjo mund të çojë në konflikte interesi dhe keqpërdorim të fondeve publike.
- Mungesa e një strukture të qartë rrit rrezikun e konflikteve të interesit dhe abuzimit.
- Neni 2(3)(a) duhet të përmbajë një mekanizëm monitorimi për të siguruar që aktivitetet promovuese dhe tregtare të mos ndërhyjnë në konkurrencën e tregut.
- Nevojitet një mekanizëm vlerësimi për ndikimin e BZH-së në ekonomi dhe mundësinë që të mos pengojë konkurrencën e bankave të tjera.

- Të implementohet një ndarje e qartë operationale dhe financiare midis aktiviteteve të mbështetura nga shteti dhe atyre tregtare, duke përdorur sisteme të pavarura kontabiliteti dhe auditimi.
- Përcaktimi i kriterëve strikte për raportimin financiar, duke u bazuar në standarde ndërkombëtare, siç bën Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Përgjigje: Mekanizmi i ndarjes do të përcaktohet në rregulloret e brendshme, duke u bazuar në standardet e kontabilitetit dhe praktikat më të mira, përfshirë edhe raportimin financiar. Subvencionimi i ndërsjellë është shprehimisht i ndaluar në këtë ligj, i cili përcakton qartë parimin e ndarjes së aktiviteteve dhe sistemin e raportimit për to.

Rregullimi i aktivitetit tregtar dhe promovues

Neni 2, që përcakton objektivat e BZH-së, thekson nxitjen e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor dhe lehtësimin e qasjes në financa. Ajo gjithashtu lejon aktivitete tregtare, të cilat duhet të jenë të ndara qartë nga aktivitetet promovuese. Ky nënkupton se është e rëndësishme që të përcaktohen politika të qarta dhe mekanizma për ndarjen e këtyre aktiviteteve, si dhe të sigurohet mbikëqyrje e plotë për të shmangur keqpërdorimin e fondeve publike për aktivitete që mund të jenë më shumë komerciale sesa promovuese.

Përcaktimi i qartë i objektivave mund të theksojë edhe rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes digjitale, duke pasur parasysh praktikat ndërkombëtare që promovojnë përdorimin e teknologjisë për të mundësuar përfshirjen financiare.

Neni mund të përmirësohet me një ndarje më të qartë të aktiviteteve promovuese dhe tregtare, duke specifikuar se aktivitetet komerciale nuk duhet të krijojnë ndikime negative për sektorët që mbështeten për zhvillim ekonomik. Për të shmangur konkurrencën të padrejtë, ndarja e aktiviteteve dhe mbikëqyrja strikte mund të forcojnë besimin në këtë model.

Përgjigje: Komenti i marre është adresuar në versionin e përditësuar të projektligjit, ku është rishikuar neni që rregullon veprimtaritë dhe është përmirësuar për të ofruar më shumë qartësi.

1. Forma Ligjore dhe Kapitali Fillestar (Nenet 3-6)

- Krijimi i BZH-së si një shoqëri aksionare është i përshtatshëm për të garantuar fleksibilitet në financim
- Pjesëmarrja e Shtetit Shqiptar me të paktën 51% siguron kontrollin publik, por kufizon pjesëmarrjen e kapitalit privat.
- Kapitali fillestar prej 10 miliardë lekësh është një angazhim i konsiderueshëm për buxhetin e shtetit dhe kërkon një analizë më të thelluar të përfitimeve afatgjata.
- Nuk ka qartësi mbi rolin e kapitalit privat vendas dhe mbajtjen e kontrollit nga shteti (Neni 5).
- Nuk është i qartë ndikimi i kapitalit fillestar në financat publike (Neni 6). Banka Nordike e Investimeve, p.sh. e ka siguruar kapitalin e saj fillestar përmes kontributeve të qeverive të vendeve anëtare dhe përdorimi i tij monitorohet rreptësisht për të garantuar që nuk ndikon negativisht në buxhetet kombëtare.

Përgjigje: Ky institucion nuk ka synim të operojë si një bankë tregtare dhe, për këtë arsye, nuk synon të ketë shumicën e aksionarëve privatë. Kufizimi i kapitalit është një masë e qëllimshme, e cila synon të ruajë natyrën dhe funksionin e tij si një mekanizëm zhvillimi dhe jo si një subjekt financiar tregtar. Banka do të funksionojë me produkte që lidhen me fonde publike dhe do të ketë një model operimi të pjesshëm në tregun financiar. Për këtë arsye, shumica e vendimmarrjes është e strukturuar në atë mënyrë që të ofrojë siguri për këto produkte, duke shmangur rreziqet që lidhen me operacionet tipike të bankave tregtare. Kjo qasje siguron që veprimtaria të mbetet

në linjë me objektivat zhvillimore dhe të mbikëqyrjet në mënyrë të përshtatshme për të garantuar stabilitet dhe përputhje me politikat publike.

- Duhet të përcaktohet më qartë në Projektligj se si do të financohet kapitali i shtetit (p.sh. përmes buxhetit të shtetit apo huamarrjes).
- Të vendosen masa sigurie që kapitali i BZH-së të mos përdoret për qëllime politike ose për të favorizuar grupe të veçanta të biznesit.
- Të krijohen mekanizma të qartë për përfshirjen e kapitalit privat, duke vendosur kufizime për të garantuar se shteti mban kontrollin dhe stabilitetin.
- Të zbatohen praktikatat e bashkë-investimeve, ku BZH do të bashkëpunojë me sektorin privat për të rritur projektet strategjike.
- Përdorimi i obligacioneve sovraane për të rritur kapitalin, siç ka bërë Agjencia Franceze për Zhvillim (AFD), duke minimizuar ndikimin direkt në buxhetin e shtetit.

Përgjigje: Kuptojmë se këto komente lidhen më shumë me fazën e implementimit. Për këtë arsye, komentet e mësipërme do të merren plotësisht parasysh gjatë miratimit të akteve nënligjore dhe në fazën e zbatimit.

Përputhshmëria me Ligjin për Shoqëritë Tregtare

Neni 3 specifikon që BZH është një shoqëri aksionare, e cila është subjekt i ligjit për shoqëritë tregtare në Shqipëri. Ky nënkupton që çdo dispozitë e Projektligjit duhet të jetë në përputhje të plotë me ligjet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e shoqërive tregtare në Shqipëri, si dhe me legjislacionin që ka të bëjë me sektorin financiar dhe bankar. Një analizë e thelluar duhet të sigurojë se çdo dispozitë ligjore e Projektligjit është në përputhje me legjislacionin e ri, nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim.

Duhet të specifikohet më qartë se si mund të forcohet transparenca në menaxhimin e kapitalit dhe se si qeveria do të mbajë kontroll mbi investimet strategjike për të shmangur ndikimet politike që mund të dëmtojnë funksionimin efikas të bankës.

Përgjigje: Është adresuar në relacionin shpjegues dhe në mënyrën e ndarjes së kompetencave midis organeve vendimmarrëse, me qëllim garantimin e pavarësisë së bankës në realizimin e objektivave të saj, për këtë qëllim janë miratuar me ligj të posaçëm disa ndryshime nga ligji për shoqëritë tregtare, duke reflektuar natyrën dhe funksionin e veçantë të bankës.

Burimet Financiare dhe Rreziku Fiskal (Nenet 7-9)

- Parashikimi që BZH të mbledhë fonde nga publiku nëpërmjet Postës Shqiptare është një risi, por ngre shqetësime mbi sigurinë e depozitave.
- Përrjashtimi i BZH-së nga tatimi mbi fitimin mund të krijojë një avantazh të padrejtë ndaj bankave tregtare dhe të shtrembërojë konkurrencën
- Projektligji krijon një avantazh të padrejtë për BZH në krahasim me bankat tregtare, veçanërisht përjashtimi nga tatimi mbi fitimin (Neni 8).
- Avantazhe të tilla mund të shtrembërojnë konkurrencën në sektorin bankar.

Përgjigje: Banka e Zhvillimit dhe bankat tregtare dallojnë në qëllimin e tyre themelor: ndërsa Banka e Zhvillimit fokusohet në mbështetjen e ekonomisë kombëtare dhe nxitjen e zhvillimit afatgjatë, bankat tregtare synojnë maksimizimin e fitimit dhe kapitalit për aksionarët e tyre. Nisur nga kjo premisë, rregullimet e propozuara nuk çenojnë konkurrencën në tregun e lirë, por përkundrazi, e plotësojnë sistemin financiar ekzistues, duke adresuar nevojat e segmenteve të pazhvilluara të tregut dhe duke nxitur një zhvillim më të ekuilibruar ekonomik.

Nuk është e qartë përgjegjësia e shtetit në rast të dështimit të BZH-së (Neni 9).

Përgjigje: Shteti gëzon të drejtat dhe përgjegjësitë si aksionar në rast dështimi, duke shtuar këtu garancinë shtetërore garancisë që mbulon disa nga instrumentet që lidhen me publikun dhe veprimtaritë promovuese.

- Duhet të parashikohet një mekanizëm garancie për depozituesit që vendosin fonde në BZH përmes Postës Shqiptare.
- Përfashtimi nga tatimi mbi fitimin duhet të justifikohet me një analizë të ndikimit ekonomik për të shmangur ankesat nga sektori privat.
- Përcaktimi i qartë i një “mbrojtjeje fiskale” ku shteti nuk mban përgjegjësi për detyrimet e BZH-së përtej kapitalit të investuar.
- Krijimi i një fondi emergjence, i cili do të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme për të mbrojtur stabilitetin financiar.

Përgjigje: Mekanizmi i garancisë për depozituesit që vendosin fonde në BZH përmes Postës Shqiptare do të parashikohet në përputhje me natyrën e produkteve të ofruara, të cilat kanë garanci shtetërore. Procedurat për këtë mekanizëm miratohen nga Ministria e Financave, duke siguruar një kornizë të qartë mbrojtëse për depozituesit.

Përgjigje: Shteti, si aksionar në një shoqëri tregtare, mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet e saj vetëm në kufijtë e kapitalit të investuar, përveç rasteve kur ka një garanci të dhënë në mënyrë të posaçme. Ky parim është shprehimisht i përcaktuar në nenin 9 të ligjit, duke qartësuar kufijtë e përgjegjësisë shtetërore dhe duke siguruar që nuk ka angazhim përtej atyre. Ky parim është plotësisht në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, i cili përcakton se aksionaret mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë vetëm në masën e kapitalit të tyre të investuar.

Shqyrtimi i përjashtimit nga tatimi mbi fitimin dhe zëvendësimi me një normë të reduktuar tatimore.

Përgjigje: Banka e Zhvillimit dhe bankat tregtare dallojnë në qëllimin e tyre themelor: ndërsa Banka e Zhvillimit fokusohet në mbështetjen e ekonomisë kombëtare dhe nxitjen e zhvillimit afatgjatë, bankat tregtare synojnë maksimizimin e fitimit dhe kapitalit për aksionarët e tyre.

Nisur nga kjo premisë, rregullimet e propozuara nuk çenojnë konkurrencën në tregun e lirë, por përkundrazi, e plotësojnë sistemin financiar ekzistues, duke adresuar nevojat e segmenteve të pazhvilluara të tregut dhe duke nxitur një zhvillim më të ekuilibruar ekonomik. Përfashtimi nga tatimi mbi fitimin është hequr nga projektligji.

Mbikëqyrja e BZH-së nga Banka e Shqipërisë për të siguruar standarde të barabarta konkurruese.

Përgjigje: Projektligji i ndryshuar parashikon një mbikëqyrje nga Banka e Shqipërisë, e cila do të rregullohet me një rregullore të posaçme, duke siguruar një kuadër të qartë dhe të strukturuar për mbikëqyrjen dhe funksionimin e institucionit.

4. Struktura e Qeverisjes (Nenet 10-16)

Struktura me Asamblenë e Përgjithshme, Këshillin Mbikëqyrës, Këshillin e Administrimit dhe Komitetin e Auditimit është një model i mirë i ndarjes së përgjegjësisë.

- Parashikimi i një shumice anëtarësh të pavarur në Këshillin Mbikëqyrës është pozitiv për qeverisjen e mirë
- Nuk ka kritere të qarta mbi kualifikimet dhe pavarësinë e anëtarëve të organeve drejtuese.
- Rreziku i ndërhyrjeve politike në vendimarrjen e BZH-së është i lartë, për shkak të mungesës së kritereve të qarta për emërimet (Nenet 10-16).
- Të përcaktohen më qartë kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Administrimit për të shmangur emërimet politike.

- Duhet të saktësohet mënyra e monitorimit të performancës së BZH-së për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.
- Krijimi i një komisioni të pavarur për përzgjedhjen e drejtuesve të BZH-së, duke përfshirë përfaqësues nga sektori privat dhe shoqëria civile.
- Zbatimi i kritereve strikte për emërimet dhe përjashtimin e drejtuesve me lidhje politike të forta.
- Neni mund të përmirësohet duke specifikuar më shumë rreth mënyrës se si bordi mbikëqyrës do të sigurojë që strategjitë e bankës të jenë gjithmonë në përputhje me objektivat kombëtare dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare.

Përgjigje: Nenet e përmendura janë rishikuar me qëllim përmirësimin e tyre. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e komenteve të mësipërme do të adresohen përmes akteve nënligjore, duke siguruar një rregullim më të detajuar dhe të përshtatur me zbatimin praktik.

Ndikimi në tregun bankar

Projektligji krijon një avantazh të padrejtë për BZH në krahasim me bankat tregtare, veçanërisht përjashtimi nga tatimi mbi fitimin (Neni 8). Kjo mund të shtrembërojë konkurrencën. KfW, banka zhvillimore gjermane, operon si një entitet i mbikëqyrur nga autoritetet bankare dhe ndjek rregulla të njëjta me bankat e tjera për taksat dhe raportimin financiar. Kjo siguron një fushë loje të barabartë për të gjithë aktorët financiarë. Ajo që mendojmë si zgjedhje është që në vend të përjashtimit nga tatimi mbi fitimin, mund të vendoset një normë e reduktuar tatimore për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës. Ndërkohë, ne mendojmë se duhet të ketë mbikëqyrje të BZH-së nga Banka e Shqipërisë për të siguruar standarde të barabarta për të gjitha institucionet financiare. Ky Projektligj për Bankën Shqiptare të Zhvillimit (BZH) përcakton rregulla dhe dispozita të rëndësishme për krijimin, organizimin dhe funksionimin e saj. Për të realizuar ndryshimet e nevojshme në ligjin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, mund të ndihmojmë duke krahasuar elemente të ligjit me praktikën ndërkombëtare dhe legjislacionin në vende të tjera, duke i lidhur këto me natyrën e veprimtarisë bankare dhe të zhvillimit. Kjo mund të ofrojë një kuadër të pasur për përmirësime, duke pasur parasysh mjedisin ekonomik dhe ligjor.

Nëse këto çështje adresohen, krijimi i BZH-së mund të sjellë përfitime të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, pa krijuar rreziqe të larta fiskale dhe konkurrencë të pabarabartë. Propozimet tona dhe ndryshimet e mundshme në ligjin për Bankën Shqiptare të Zhvillimit synojnë rritjen e efikasitetit dhe transparencës, duke përdorur praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo mund të arrihet përmes përmirësimit të strukturës menaxhuese, qartësisë në ndarjen e aktiviteteve tregtare dhe zhvillimore, dhe sigurisë në mbikëqyrjen financiare.

Përgjigje: Përmbledhja e komenteve gjen përgjigje në analizën e mësipërme.

Komentet e Shoqatës Shqiptare të Bankave

AAB mbështet krijimin e një banke zhvillimi si një shoqëri tregtare me status të veçantë që i bindet modeleve më të përparuara dhe më bashkëkohore. Një bankë zhvillimi krijohet për koordinimin dhe drejtimin e fondeve nga buxheti i shtetit, të ndihmave, granteve, donacioneve, kredive nga brenda dhe jashtë vendit, me qëllim mbështetjen e financimit të sektorëve të nënfinancuar dhe projekteve të mëdha kombëtare apo rajonale.

Komisioni Evropian ka vendosur rregulla për rolin e National Promotion Bank (NPB) në mbështetjen e Planit të Investimeve për Evropën. Arsyeja kryesore ekonomike për një bankë promovuese është që të mbulojë atë fushë /sektor /industri që bankat private nuk e kanë përmbushur, por pa cenuar tregun dhe kushtet e barabarta. Në këtë frymë duhet të ndërtohet edhe projekt-ligji, me qëllim që të ofrojë zbatimin e politikave të duhura për të siguruar që efektet

e mundshme anësore negative të veprimit të NPB-së të mos materializohen, për shembull, ndër të tjera:

- shpërndarja e gabuar e investimeve për shkak të ndërhyrjeve politike;
- mbajtja e strukturave joefikase të tregut, sektorëve me mbi kapacitet ose mbështetje për ndërmarrjet në vështirësi;
- dalja nga tregu e financuesve të sektorit privat, duke penguar kështu zhvillimin e sektorit financiar.

Pra, parimi themelor i projekt-ligjit duhet të jetë ofrimi i sigurisë për një treg ku operatorët operojnë në kushte të barabarta, veçanërisht në tregjet ku konkurrojnë ndërmarrjet shtetërore dhe subjekte të sektorit privat, me qëllim shmangien e deformimit të tregut. Për të parandaluar skenarët e mësipërm, standardet e larta të transparencës dhe llogaridhënies janë të rëndësishme për reputacionin e NPB-ve në treg, si dhe menaxhimin profesional dhe shkallën e nevojshme të pavarësisë.

Siç është paraqitur projekt ligji, si AAB, jemi për riformulim dhe përmirësim të parashikimeve të tij në nenet 2, 4, 7, dhe 23.

Përgjigje: Komentet e mësipërme janë adresuar duke përmirësuar nenet përkatëse të projektligjit, konkretisht: Nenin 2 (Objekti), Nenin 4 (Veprimtaria e Bankës Shqiptare të Zhvillimit), Nenin 8 (Burimet Financiare), si dhe Nenit 22 deri në 25 (të ndryshuar).

AAB mbështet bashkëpunimin e BZh me industrinë bankare për ndarjen e rrezikut, bashkëfinancim dhe mobilizim të kapitalit privat. Këto tre shtylla janë të rëndësishme për të qenë qëllimi i veprimtarisë së BZh.

Konkretisht:

Ndarje e rrezikut – dhënie garancie bankave tregtare për të financuar sektorë të nënfinancuar për shkak të riskut të lartë. Sektorët mund të identifikohen nga programet prioritare të qeverisë, nga kontributi në PPB dhe pesha në portofolin e huas, nga kërkesat për modernizim dhe produktivitet më të lartë.

Bashkëfinancim – pjesëmarrje e përbashkët me bankat në projekte me kosto të lartë, për të cilat bankat nuk mund të financojnë mbi një shumë të caktuar. Në këto projekte mund të hyjë BZh bazuar në analizat e riskut dhe përfitueshmërisë të kryera nga bankat tregtare dhe kushtet tregtare të tyre.

Mobilizim të kapitalit privat – E drejta e BZh për të investuar në tituj, për të qenë aksionare në shoqëri që duhet të ngrihen apo të arrijnë një nivel tjetër teknologjik, përmasor apo zhvillimor.

Përgjigje: Komentet e mësipërme janë adresuar në Projektligjin e rishikuar, në nenet që rregullojnë objektivat, parimet dhe veprimtarinë e Bankës Shqiptare të Zhvillimit, ku është theksuar qartë bashkëfinancimi dhe ndarja e rrezikut si parime thelbësore të funksionimit të bankës. Po ashtu është përcaktuar qartë përgjegjësia e organeve drejtuese persa i takon menaxhimit të riskut dhe komiteeve përkatëse për të.

BZh nuk mund të mbledhë fonde në para nga publiku (qofshin këto fonde /depozita nga individët, shoqëritë tregtare private dhe shtetërore). Nëse duhet të kryejë këtë funksion, ajo duhet të licencohet si institucion financiar dhe të zbatohet të gjithë kuadrin ligjor në fuqi për mbledhjen dhe sigurimin e depozitave. Nga ana tjetër, krijimi i BZh nuk duhet të konkurrojë sektorin bankar, por duhet të jetë plotësues /komplementar me të. Në kushtet që kjo shoqëri do të operojë si një subjekt tregtar i pavarur, i pa mbikëqyrur apo fakti që fondet që përbëjnë burim financimi, vijnë nga publiku, por nuk do të sigurohen nga ASD, dhe do të jenë qind për qind të sigurta, krijojnë kushte të pafavorshme dhe jo konkurruese në treg, duke sjellë një shtrembërim

të konkurrencës së lirë. Në rast nevojë për fonde, BZh mund të emetojë obligacione në publik duke zgjeruar instrumentet e tregut financiar.

Përgjigje: Projektligji sanksionon nenin 4 që roli i Bankës së Zhvillimit në financim është plotësues i tregut bankar dhe jo konkurrues. Sa i takon mbledhjes së kursimeve, ky mekanizëm është marrë nga praktikat më të mira ndërkombëtare, me synimin për të siguruar akses financiar për segmentin e fundit të popullsisë që mbetet jashtë sistemit bankar.

Në Projektligjin e rishikuar, është përcaktuar se llojet e produkteve, karakteristikat e tyre, përfshirë kufizimet në vlerë, përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë, duke respektuar parimet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe dispozitat e përcaktuara në ligjin që rregullon sigurimin e depozitave .

Për sa i takon garancisë shtetërore, kjo është e lidhur drejtpërdrejt me qëllimin e përdorimit të fondeve publike. BZH nuk operon me synim fitimi si bankat tregtare, dhe fondet e mbledhura përdoren ekskluzivisht për qëllime zhvillimore, jo për krijimin e fitimit. Për këtë arsye, parashikohet një mekanizëm i posaçëm garancie.

BZH dhe bankat tregtare ndryshojnë në qëllimin e tyre primar: ku BZH synon mbështetjen e ekonomisë kombëtare dhe zhvillimin afatgjatë, ndërsa bankat tregtare synojnë fitimin dhe maksimizimin e kapitalit për aksionaret. Duke u bazuar në këtë premisë, rregullimet e propozuara nuk cenojnë konkurrencën në tregun e lirë, por përkundrazi, ndihmojnë në plotësimin e sistemit financiar ekzistues, duke synuar zhvillimin e segmenteve të pazhvilluara të tregut.

Marrëdhënia e BZh me BSh nuk mund të lihet në ligj me një marrëveshje që duhet lidhur midis palëve (po në rast se marrëveshja nuk lidhet?), por të përcaktohen qartë në ligj të drejtat dhe detyrimet që do të ketë BZh në zbatimin e kërkesave rregullative të kredithënies, të provigjionimit të kredive, të raportimit të tyre (në regjistrin e kredive sot dhe nesër edhe në byronë e kredisë), etj., aspekte këto të rëndësishme të funksionimit të BZh.

Përgjigje: Komentet e mësipërme janë adresuar në Projektligjin e rishikuar, ku është shtuar një rregullim i posaçëm për marrëdhënien dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të mbledhjes së fondeve të kthyeshme, duke përcaktuar qartë mekanizmat e kontrollit dhe përgjegjësitë përkatëse.

Si një institucion me shumë përjashtime nga kuadri ligjor ekzistues dhe për faktin se shumica e aksioneve do t'i takojë gjithmonë shtetit, nuk është e qartë se si do të realizohet transparenca dhe llogaridhënia. Nuk ka në projekt-ligj asnjë institucion apo strukturë shtetërore që mbikëqyr këtë ndërmarrje shtetërore të pazakontë. Mbikëqyrja e kujdesshme e ushtruar në mënyrë të pavarur nga një subjekt i veçantë e forcon më tej reputacionin e BZh. Referuar relacionit shoqëruar të projekt ligjit sipas të cilit ky projekt ligj është hartuar në bashkëpunim me Cassa Depositi e Prestiti (CDP) të Italisë dhe duke marrë eksperiencën e këtij institucioni, theksojmë se në rastin e CDP-së ka një Komision Parlamentar Mbikëqyrës për Cassa Depositi e Prestiti, mbi performancën e përgjithshme të administrimit të CDP-së, të administrimit të fondeve të publikut dhe në çdo rast fondet e mbështetura nga garancia shtetërore.

Përgjigje: Komentet e mësipërme janë adresuar në Projektligjin e rishikuar, ku është parashikuar detyrimi për raportim periodik në Këshillin e Ministrave dhe në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, duke siguruar transparenca dhe llogaridhënie në veprimtarinë e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

Neni 4 “Objekti i Veprimtarisë”, pika 1, parashikon që: “1. Për arritjen e objektivave të saj, BZH është e autorizuar, ndër të tjera...”, termi “ndër të tjera” është jo korrekt referuar teknikës

legjislative, pasi ligji synon të rregullojë dhe normojë në mënyrë të përcaktuar aktivitetin që do të ushtrohet nga BZh, çka do të thotë që do të duhet të jetë i mirë përcaktuar objekti i veprimtarisë.

Përgjigje: Komentet e mësipërme janë adresuar në **Projektligjin e rishikuar**.

Konsultimi me praninë e Bashkimi Evropian ne Shqipëri

Pas takimit të datës 5 shkurt 2025, nga ana e BE u paraqitën një sërë komentesh me shkrim, të cilat u diskutuan në një takim të dytë. Këto komente u adresuan kryesisht në projektligjin e rishikuar.

Çështjet kryesore të adresuara lidhen me:

- Saktësimin e objektivave të Bankës së Zhvillimit;
- Përparësinë e projekteve të qëndrueshme;
- Përputhshmërinë me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave;
- Saktësimin e territorialitetit të Bankës së Zhvillimit.

Gjithashtu, u adresua përputhshmëria e dispozitave të projektligjit me ligjin që rregullon sigurimin e depozitave.

Komentet e tjera në lidhje me organizimin dhe strukturën qeverisëse, përfshirë pavarësinë, kualifikimet dhe kriteret për organet drejtuese, u reflektuan në projektligjin e rishikuar.

Një pjesë e madhe e këtyre çështjeve do të gjejnë pasqyrim në aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të ligjit.

Nevoja për të përcaktuar qartë që Banka Shqiptare e Zhvillimit (BZH) do të investojë vetëm në shoqëri që kanë një perspektivë fitimprurëse, me qëllim shmangien e shqetësimeve në lidhje me konkurrencën.

Përgjigje: Ky aspekt është adresuar dhe përfshirë në nenin 4.1 dhe 4.3 të projektligjit, duke saktësuar se Banka Shqiptare e Zhvillimit do të investojë vetëm në kompani me një perspektivë të qëndrueshme fitimprurëse, në përputhje me rregullat e konkurrencës dhe mbështetur në një analizë të qartë të riskut dhe qëndrueshmërisë financiare të investimeve.

Në vijim, Bashkimi Evropian thekson kërkesën që çështjet që nuk trajtohen në mënyrë të qartë në legjislacion të sqarohen në mënyrë të plotë dhe të detajuar në kuadrin e miratimit të rregulloreve dhe akteve nënligjore përkatëse, duke përfshirë aspektet e mëposhtme: Përcaktim më të qartë të strukturës së qeverisjes, duke përfshirë përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese

- Përbërja dhe funksionimi i komiteteve të bordit dhe komiteteve këshillimore
- Përcaktim më të qartë të strukturës së menaxhimit të riskut
- Kod sjelljeje për anëtarët e bordit drejtues dhe mbikëqyrës
- Përcaktim më të qartë të marrëdhënieve financiare me qeverinë
- Kufizimi i risqeve të mundshme në lidhje me Ndihmën Shtetërore dhe Konkurrencën
- Rregullimi i procesit të mbledhjes së depozitave dhe fondeve të kthyeshme nga një entitet i licencuar nga Banka e Shqipërisë.

Përgjigje: Komentet e tjera të prezantuara nga Bashkimi Evropian janë marrë në konsideratë si më poshtë:

- Ligji përcakton qartë se mbledhja e kursimeve dhe fondeve të kthyeshme do të mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë, duke siguruar përputhshmëri me rregullat dhe standardet rregullatore sipas një metodologjie të propozuar nga Banka e Shqipërisë dhe e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Janë saktësuar më tej rregullimet në lidhje me ndihmën shtetërore dhe konkurrencën, si dhe detyrimi për zbatimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikën e Bashkimit Evropian.
- Janë sqaruar më tej marrëdhëniet financiare me qeverinë, duke përcaktuar natyrën e financimit dhe mënyra e përcaktimit të menaxhimit të llogarive bankare në thesarin e shtetit dhe në Bankën e Shqipërisë.
- Është sugjeruar nevoja për të përcaktuar qartë që Banka Shqiptare e Zhvillimit (BZH) do të investojë vetëm në shoqëri që kanë një perspektivë fitimprurëse, me qëllim shmangien e shqetësimeve në lidhje me konkurrencën. Ky aspekt është adresuar dhe përfshirë në nenin 4.1 dhe 4.3 të projektligjit, duke saktësuar se Banka Shqiptare e Zhvillimit do të investojë vetëm në shoqëri me një perspektivë të qëndrueshme fitimprurëse, në përputhje me rregullat e konkurrencës dhe mbështetur në një analizë të qartë të riskut dhe qëndrueshmërisë financiare të investimeve.

Aspektet e tjera të ngritura, konkretisht:

- Përcaktimi më i qartë i strukturës së qeverisjes, përfshirë përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese;
- Përbërja dhe funksionimi i komiteteve të bordit dhe komiteteve këshillimore;
- Përcaktimi më i qartë i strukturës së menaxhimit të riskut;
- Kodi i sjelljes për anëtarët e bordit drejtues dhe mbikëqyrës;
- Përfshirja e përfaqësuesve të sektorëve të ekonomisë në këshillin mbikëqyrës.

Keto pika do të trajtohen më tej në statut dhe aktet nënligjore. Për hartimin e tyre do të ndiqen standardet më të mira të qeverisjes korporative, duke siguruar transparencë, funksionim efikas dhe ndarje të qartë të përgjegjësisë në menaxhimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) do të realizohet përmes krijimit të një kuadri ligjor dhe rregullator të qartë, i cili do të përcaktojë funksionimin dhe mbikëqyrjen e saj. Banka do të kapitalizohet fillimisht nga fondet publike dhe do të angazhohet në mobilizimin e financimeve shtesë nga investitorët privatë dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Për të siguruar një integritet të balancuar me tregun, do të krijohen mekanizma bashkëpunimi me bankat tregtare dhe do të vendosen skema garantimi dhe bashkëfinancimi për të shmangur mbivendosjen me sektorin privat.

Monitorimi do të bazohet në një sistem të detajuar raportimi dhe mbikëqyrjeje, duke përfshirë raporte vjetore dhe pasqyra financiare të aksesueshme publikisht, si dhe shqyrtimin e mundësisë për raportime tremujore. Për të garantuar transparencën dhe efikasitetin operacional, do të vendosen mekanizma të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, ndërsa matja e ndikimit të BZH-së do të bëhet përmes treguesve kryesorë, si numri dhe vlera e kredive të dhëna për sektorët strategjikë, efikasiteti i përdorimit të kapitalit dhe kontributi në zhvillimin e infrastrukturës dhe inovacionit.

Kjo qasje do të sigurojë një zbatim të qëndrueshëm dhe monitorim të vazhdueshëm, duke rritur transparencën dhe efektivitetin e operacioneve të BZH-së dhe duke garantuar përmbushjen e

objektivave zhvillimore në përputhje me politikat kombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

PJESA 2. BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Në Shqipëri, mbështetja financiare për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe për projektet e rëndësishme infrastrukturore, është zhvilluar ndër vite përmes një kornize rregullatore të ndërtuar kryesisht mbi instrumentet e financimit buxhetor, grantet publike, garancitë sovrane dhe huamarrjen me interesa të lehtësuara nga institucionet financiare ndërkombëtare. Në sferën e NVM-ve, qeveria ka mundësuar një sërë programesh grantesh, kryesisht të hartuara me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, të cilat synonin të mbulonin fusha të tilla si bujqësia, manifaktura, fasoneria apo startup-et inovative. Kjo mbështetje, pavarësisht rëndësisë së saj për rritjen e konkurrueshmërisë dhe modernizimin e sektorit privat, ka qenë e limituar në fondet e akorduara nga buxheti vjetor i shtetit dhe fragmentohej në disa skema sektoriale, gjë që shpesh ka çuar në mosplotësimin e nevojave të gëra për financime afatgjata. Paralelisht, qeveria ka ushtruar edhe opsionin e garancisë sovrane, duke i dhënë mundësi subjekteve private të marrin kredi me kushte më të favorshme, pasi një pjesë e rrezikut përballohej nga shteti. Por, edhe ky mekanizëm mbetet i kushtëzuar nga aftësia fiskale dhe nga nevoja për të ruajtur stabilitetin makroekonomik. Sa u takon projekteve strategjike, një pjesë e tyre vazhdon të financohet përmes buxhetit të shtetit, shpesh në bashkëpunim me organizata financiare ndërkombëtare që ofrojnë kredi koncesionale ose grante të posaçme. Këto marrëveshje, të cilat zakonisht ratifikohen në Kuvend, i lejojnë vendit të ketë qasje në fonde afatgjata, por përsëri janë të kushtëzuara nga tavani i borxhit publik dhe nga disiplinat fiskale që Shqipëria ka ndërmarrë.

Është e rëndësishme të nënvizohet se, përtej instrumenteve të granteve, garancive sovrane dhe huamarrjes së butë, shumë vende kanë krijuar Banka Kombëtare të Zhvillimit (NPBs) në përputhje me Komunikimin e Komisionit Evropian COM (2015) 361 final, duke i vendosur ato në qendër të strategjive kombëtare për financimin e projekteve infrastrukturore, inovacionit dhe zhvillimit të sektorit privat.

Këto institucione paraqesin një formë mbështetjeje që plotëson, por nuk zëvendëson, ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të shtetit në ekonomi. Në vend që të veprojnë si një “krah” i drejtpërdrejtë buxhetor, NPB-të mobilizojnë kapital privat dhe publik, duke synuar financimet afatgjata e të qëndrueshme në sektorë me vështirësi strukturore për të tërhequr investime. Kjo i bën ato veçanërisht të rëndësishme për mbështetjen e bujqësisë, turizmit, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), si dhe projekteve infrastrukturore.

Shqipëria mund të ndjekë modelet e suksesshme të bankave të zhvillimit në Evropë dhe rajonin e Ballkanit, të cilat kanë luajtur një rol kyç në mobilizimin e kapitalit privat, përrhithjen e fondeve ndërkombëtare dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik

Në Evropë dhe Ballkan, disa banka zhvillimi janë shfaqur si shembuj të suksesshëm të institucioneve promovuese që mbështesin zhvillimin ekonomik, inovacionin dhe infrastrukturën.

Një nga modelet më të njohura në Evropë është Cassa Depositi e Prestiti (CDP) në Itali. CDP ka qenë thelbësore për financimin e projekteve infrastrukturore, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe sektorit të eksportit, duke ofruar një model të fuqishëm të një banke promovuese.

Në Francë, Banque Publique d'Investissement (Bpifrance) ka luajtur një rol kyç në mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm përmes kredive, investimeve dhe garancive. Një aspekt i rëndësishëm i suksesit të saj është aftësia për të përthithur fondet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në sektorët e inovacionit dhe energjisë së pastër. Struktura e Bpifrance bazohet në një model të fortë bashkëpunimi publik-privat, duke ofruar një shembull të qartë se si një bankë zhvillimi mund të arrijë rezultate të qëndrueshme.

Në Portugali, Banco Português de Fomento (BPF) është një tjetër shembull i shkëlqyer i një banke zhvillimi. BPF fokusohet në mbështetjen e rritjes ekonomike dhe eksporteve përmes mekanizmave të garancisë financiare dhe bashkë-financimit me investitorë privatë. Banka ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian, të cilat përdoren për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës dhe projekteve të inovacionit.

Në Ballkan, Banka Kroate për Rindërtim dhe Zhvillim (HBOR) ka përdorur fondet e Bashkimit Evropian për të investuar në ndërmarrje të vogla dhe projekte madhore infrastrukturore. HBOR ka një model fleksibil dhe mbështet bizneset eksportuese dhe projektet inovative që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Kroacisë.

Në Maqedoninë e Veriut, Banka për Zhvillim fokusohet kryesisht në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe financimin e projekteve infrastrukturore. Ajo bashkëpunon ngushtë me qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë, duke ofruar një model të suksesshëm të integritetit të resurseve të brendshme dhe të jashtme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Këto raste dëshmojnë se bankat e zhvillimit luajnë një rol strategjik në përthithjen e kapitalit privat dhe në përdorimin efikas të fondeve publike. Ato e realizojnë këtë duke qenë një “urë” mes aktorëve privatë dhe objektivave kombëtare të zhvillimit, me qëllim që fondet të kanalizohen drejt projekteve me përfitime afatgjata dhe me ndikim strukturor. Ndryshe nga mbështetja e drejtpërdrejtë buxhetore e shtetit, e cila shpesh kufizohet nga afatet vjetore, huamarrja shtetërore ose disiplina fiskale, Bankat Kombëtare të Zhvillimit krijojnë një mjedis më fleksibël. Ato përthithin kursimet vendase dhe burimet e donatorëve, shpërndajnë rrezikun, ofrojnë financime me afatgjatësi të mjaftueshme dhe i japin prioritet investimeve me rëndësi strategjike që mund të mos ishin tërheqëse për tregun privat.

Edhe pse NPB-të shpesh perceptohen si një formë “zgjatjeje e shtetit” në treg, roli i tyre nuk është të zëvendësojnë grantet apo garancitë sovraane, por t'i komplementojnë ato. Kur një projekt kërkon një volum të lartë fondesh ose ekspozohet ndaj një rreziku që tregu privat e shmang, qasja e kombinuar e skemave buxhetore të shtetit me huadhënien apo investimin e një banke zhvillimi mundëson zgjerimin e “hapësirës fiskale”. Nga njëra anë, fondet publike mund të orientohen selektivisht në sektorë me ndikim social apo strategjik të lartë, ndërsa, nga ana tjetër, NPB-të sigurojnë një ekuilibër financiar duke mobilizuar investitorë privatë, bankat e nivelit të dytë apo

fondet e pensioneve. Në këtë mënyrë realizohet një efekt shumëzues shumë më i madh sesa do të ishte rasti me financim tërësisht publik ose tërësisht privat.

Problemi në Shqyrtim

- *Përshtetja natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkakun e problemit.*
- *Përshtetja shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Pavarësisht skemave të mbështetjes publike nëpërmjet granteve, garancive sovrane dhe bashkëpunimeve me organizatat financiare ndërkombëtare, Shqipëria vijon të përballë me boshllëqe të theksuara në financim. Duhet theksuar se, kjo mbështetje ka qenë e limituar në fondet e akorduara nga buxheti vjetor i shtetit dhe fragmentohet në disa skema sektoriale, gjë që shpesh ka çuar në mosplotësimin e nevojave të gjera për financime afatgjata. Edhe mekanizmi i garancisë sovrane mbetet i kushtëzuar nga aftësia fiskale dhe nga nevoja për të ruajtur stabilitetin makroekonomik. Ekonomia shqiptare përballë me mungesë të theksuar të financimit për sektorët e nënfinancuar, si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), bujqësia, turizmi, infrastruktura dhe inovacioni. Bankat tregtare operojnë kryesisht me një model konservator kredihënijeje, duke favorizuar sektorët me rrezik të ulët dhe duke shmangur kreditimin për iniciativë të reja ose për biznese që nuk kanë kolateral të fortë.

Problematika e paraqitur ka natyrë rregullatore, pasi lidhet me mungesën e një kornize ligjore dhe institucionale që do të mundësonte krijimin e një institucioni financiar të specializuar për zhvillimin ekonomik, si një bankë zhvillimi. Mungesa e një kuadri të tillë rregullator pengon jo vetëm krijimin e këtij institucioni, por edhe aksesin e Shqipërisë në mekanizmat ndërkombëtarë të financimit, siç janë linjat e kreditimit nga Banka e Investimeve Evropiane dhe fondet e BE-së

Qasje e kufizuar në financa për NVM-të dhe startup-et

Boshllëku i financimit për këtë segment të ekonomisë arrin në 9.4% të PBB-së (~1 miliard euro). Bankat tregtare kanë standarde të rrepta për dhënien e kredive, ku kriteret e kolateralit shpesh janë të papërballueshme për NVM-të dhe startup-et. Për më tepër, mungesa e një ekosistemi të zhvilluar të kapitalit të rrezikut dhe investimeve engjell e bën të vështirë financimin e bizneseve të reja inovative. Kultura e ulët e investimeve alternative dhe mungesa e stimuljeve fiskale për investitorët privatë thellojnë këtë problematikë.

Mungesa e mbështetjes për bujqësinë dhe turizmin

Këta sektorë marrin më pak se 6% të kredive bankare, megjithëse kanë një rol kyç në ekonominë shqiptare. Bankat i shohin si sektorë me rrezik të lartë për shkak të varësisë nga faktorët klimatikë dhe sezonalitetit. Për më tepër, mungesa e skemave të garantuara të financimit dhe sigurimeve për prodhimet bujqësore i dekurajon investimet. Në bujqësi, mungesa e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, si dhe fragmentimi i pronësisë mbi tokën, krijojnë vështirësi shtesë. Për turizmin, investimet e kufizuara në promovimin dhe diversifikimin e ofertës turistike pengojnë shfrytëzimin e plotë të potencialeve të vendit.

Investime të pamjaftueshme në infrastrukturë

Shqipëria ka nevojë për projekte të mëdha në transport, energji dhe transformim digjital, por mungon financimi i dedikuar. Pra, fondet publike janë të kufizuara dhe borxhi publik nuk mund të rritet pa rrezikuar stabilitetin fiskal. Partneritetet publike-private (PPP) shpesh kanë pasur problematika në zbatimin e tyre, duke krijuar mungesë besimi tek investitorët. Për më tepër, mungesa e planeve të qarta urbanistike dhe zhvillimore shpesh krijon pengesa në realizimin e projekteve afatgjata.

Pabarazi rajonale dhe mungesë e investimeve në zonat rurale

Zonat jashtë Tiranës nuk kanë qasje të mjaftueshme në financime, duke thelluar pabarazitë ekonomike. Infrastrukturat e dobëta, mungesa e shërbimeve financiare dhe mbështetja e kufizuar e politikave qeveritare për bizneset rurale e vështirësojnë zhvillimin ekonomik të këtyre zonave. Po ashtu, mungesa e edukimit financiar dhe aftësive menaxheriale kufizon aftësinë e bizneseve lokale për të tërhequr financime dhe për të menaxhuar me sukses projektet e tyre.

Identifikimi i Shkaqeve të Problemit

Shqipëria nuk ka një institucion financiar të specializuar për financimin e zhvillimit ekonomik, siç ndodh në vende të tjera të rajonit. Një bankë zhvillimi mund të sigurojë kredidhënie të lehtësuara për sektorët prioritarë, të lehtësojë aksesin në fondet e BE-së dhe të shërbejë si një mekanizëm për mbështetjen e projekteve strategjike. Mungesa e këtij institucioni kufizon aksesin e vendit në linjat e kreditimit dhe instrumentet e tjera financiare që kanalizohen përmes bankave zhvillimore nga Banka e Investimeve Evropiane. Si rezultat, kjo redukton kapacitetin e Shqipërisë për të mbështetur projekte strategjike me ndikim afatgjatë në zhvillimin ekonomik dhe social.

Ndërkohë, konkurrueshmëria e vendit rrezikon të dobësohet në tregun rajonal dhe ndërkombëtar. Nëse nuk krijohen instrumente që të kombinojnë fonde publike e private me kapacitet mjaftueshëm të lartë për të mbështetur investime afatgjata, Shqipëria do të hasë vështirësi të konsiderueshme në përmbushjen e objektivave të saj të zhvillimit social dhe ekonomik.

Shtirja e Problemit

Problemi shtrihet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë të gjitha aspektet e juridiksionit dhe zbatueshmërisë ligjore në këtë hapësirë.

Identifikimi i grupeve të prekura

Grupi i Prekur	Ndikimi Kryesor
Qeveria	Vështirësi në financimin e projekteve strategjike, mungesë e një mekanizmi për tërheqjen e fondeve të BE-së.
Bizneset (NVM dhe startup-et)	Akses i kufizuar në kredi dhe investime, vështirësi në rritjen dhe zgjerimin në tregjet ndërkombëtare.

Grupi i Prekur	Ndikimi Kryesor
Shoqëria civile dhe qytetarët	Më pak vende të reja pune, pabarazi ekonomike dhe mungesë investimesh në infrastrukturë.
Bashkitë dhe institucionet vendore	Pamundësi për të zhvilluar projekte afatgjata për komunitetet lokale.
Investitorët privatë dhe tregu financiar	Mungesë e një platforme bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat për investime të përbashkëta.

Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

Po, ky problem mund të trajtohet përmes një ndryshimi të politikave, konkretisht përmes krijimit të një Banke të Zhvillimit që do të adresonte boshllëqet e tregut financiar duke ofruar:

- Kredi dhe garanci financiare për sektorët strategjikë dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme.
- Instrumente financiare për të mobilizuar kapital privat dhe për të përthithur fonde evropiane.
- Mbështetje për projekte publike dhe infrastrukturën kombëtare.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria planifikon të ndërhyjë në krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit (Banka Shqiptare e Zhvillimit - BZH) për të adresuar boshllëqet e sistemit financiar dhe për të siguruar një mekanizëm të qëndrueshëm për zhvillimin ekonomik. Kjo ndërhyrje është e nevojshme për disa arsye kryesore:

- Banka Shqiptare e Zhvillimit do të sigurojë financim të qasshëm dhe të qëndrueshëm për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), të cilat shpesh përballen me kufizime në aksesin në kredi për shkak të mungesës së garancive dhe kushteve të favorshme të tregut financiar.
- Banka Shqiptare e Zhvillimit do të luajë një rol kyç në mbështetjen e eksporteve duke siguruar instrumente financiare të posaçme, si garanci kredie dhe mbështetje për zgjerimin në tregjet ndërkombëtare. Kjo do të ndihmojë bizneset shqiptare të rrisin kapacitetet prodhuese dhe të përmirësojnë konkurrueshmërinë e tyre në eksport.
- Banka Shqiptare e Zhvillimit do të sigurojë financim afatgjatë për projektet që kërkojnë mbështetje të qëndrueshme dhe do të krijojë mekanizma garantimi për tërheqjen e investitorëve privatë dhe ndërkombëtarë.
- Banka Shqiptare e Zhvillimit do të shërbejë si një instrument për menaxhimin dhe drejtimin strategjik të burimeve financiare, duke siguruar alokimin e tyre në sektorë me rëndësi zhvillimore.

- Krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit do të mundësojë një platformë efektive për ndërmjetësimin e fondeve publike dhe private, duke përmirësuar qasjen në financim për projekte me impakt të lartë ekonomik dhe social.
- Banka Shqiptare e Zhvillimit do të ofrojë një strukturë të dedikuar për zhvillimin e sektorëve prioritarë, duke plotësuar dhe forcuar sistemin ekzistues të financimit.

Në këtë mënyrë, Banka Shqiptare e Zhvillimit do të jetë një mekanizëm kyç për nxitjen e zhvillimit ekonomik, për rritjen e investimeve në sektorë strategjikë, për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) dhe për forcimin e kapaciteteve të eksporteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Shpjegoni se çfarë shprehon të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.

Qeveria synon që përmes BZH të adresojë disa nga sfidat kryesore të sistemit financiar dhe të krijojë një mekanizëm të qëndrueshëm për zhvillimin ekonomik dhe investimet strategjike.

Përmirësimi i aksesit në financim për bizneset

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe startup-et shpesh përballen me vështirësi në marrjen e kredive, për shkak të kërkesave të larta për kolateral dhe kushteve të rrepta të bankave tregtare. BZH do të ofrojë garanci për kreditimin e tyre dhe huadhënie indirekte përmes bankave, duke lehtësuar aksesin në kapital.

Financimi i sektorëve strategjikë

Projektet e mëdha në infrastrukturë, energji të rinovueshme, bujqësi dhe teknologji kërkojnë financime afatgjata, të cilat bankat tregtare nuk i ofrojnë në mënyrë të qëndrueshme. BZH do të mbushë këtë boshllëk duke siguruar financim afatgjatë dhe mekanizma bashkëfinancimi me institucionet ndërkombëtare.

Mobilizimi i kapitalit privat dhe fondeve ndërkombëtare

Shqipëria ka akses në financime nga BE, por mungon një strukturë e dedikuar për menaxhimin e tyre në mënyrë të efektshme. BZH do të veprojë si një instrument për të përthithur dhe administruar këto fonde, duke rritur investimet në sektorët prioritarë.

Reduktimi i fragmentimit të tregut financiar

Aktualisht, sistemi financiar shqiptar është i përqendruar kryesisht në kreditimin e konsumit dhe pasurive të paluajtshme, duke lënë sektorët produktivë pa mbështetje të mjaftueshme. BZH do të plotësojë këtë boshllëk duke vepruar si një instrument zhvillimor dhe jo konkurrues me bankat tregtare.

Ulja e varësisë nga financimi publik

Projektet e zhvillimit ekonomik shpesh varen nga fondet publike, duke krijuar presion mbi buxhetin e shtetit. Me krijimin e BZH, qeveria synon të transferojë këtë barrë financiare drejt mekanizmave të tregut dhe partneriteteve publike-private.

Mbështetja e sipërmarrjeve dhe rritja e aksesit në financim

BZH do të ndihmojë bizneset e vogla, të mesme dhe startup-et të kenë qasje më të lehtë në financim, duke mbështetur objektivin e qeverisë për zhvillimin e sektorit privat dhe fuqizimin e sipërmarrjes.

Zhvillimi i sektorëve strategjikë

BZH do të financojë infrastrukturën, energjinë e rinovueshme dhe teknologjinë, duke mbështetur objektivat e qeverisë për rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e sektorëve me potencial të lartë rritjeje.

Forcimi i lidhjes midis qeverisë dhe sektorit privat

BZH do të shërbejë si një mekanizëm për mobilizimin e kapitalit privat dhe përthithjen e fondeve ndërkombëtare, duke ndihmuar qeverinë të krijojë një treg financiar më të qëndrueshëm dhe të integruar me praktikatat evropiane.

Përmirësimi i integritetit evropian dhe përdorimi më efikas i fondeve të BE-së

Me krijimin e BZH, përdorimi i fondeve të BE-së do të bëhet më efikas, duke ndihmuar Shqipërinë të përmbushë kërkesat e integritetit në BE dhe të përfitojë më shumë nga programet e investimeve evropiane.

Krijimi i një sistemi të drejtë dhe transparent të financimit zhvillimor

Përmes mekanizmave të mbikëqyrjes dhe transparencës, BZH do të sigurojë një përdorim efektiv të fondeve publike, duke forcuar besimin e investitorëve dhe të sektorit privat në qeverisjen ekonomike.

Përmes BZH, qeveria synon të krijojë një mekanizëm të qëndrueshëm për kreditimin dhe investimet strategjike, duke mbështetur zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë dhe forcimin e sistemit financiar shqiptar, në përputhje me praktikatat më të mira evropiane.

Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.

Ndërhyrja e qeverisë për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) është një masë strategjike që synon të plotësojë boshllëqet e tregut financiar dhe të mbështesë rritjen ekonomike të vendit. Kjo ndërhyrje do të realizohet në disa nivele kryesore për të siguruar funksionimin e suksesshëm të institucionit dhe për të arritur objektivat e tij zhvillimore.

Procesi fillon me ndërmarrjen e një politike të qartë zhvillimore, e cili do të përcaktojë mandatin, funksionet dhe mekanizmat operativë të BZH. Kjo nisëm do të garantojë që BZH të operojë si një bankë zhvillimi dhe jo si një bankë tregtare, duke siguruar financim për sektorët prioritarë dhe duke mobilizuar kapital privat.

Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

Krijimi i BZH është plotësisht i harmonizuar me objektivat e nivelit të lartë të qeverisë shqiptare,

duke synuar zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së investimeve, në përputhje me acquis-në e Bashkimit Evropian mbi shërbimet financiare, konkurrencën dhe parimin e ekonomisë së lirë.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 - 2030, dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, janë hartuar si një dokument politikash afatmesëm i shtrirë në 6 vite duke qenë në këtë mënyrë në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030. Njëkohësisht, draft strategjia është hartuar në përputhje dhe kontribuon në realizimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Në strategji përcaktohet se, në nivelin makro, politikat publike dhe mbështetja politike janë faktorë të rëndësishëm mundësues për industrinë e përgjithshme dhe ekosistemin sipërmarrës. Sa i përket mbështetjes kombëtare, niveli makro është vendi ku aktorët qeveritarë mund të kontribuojnë më shumë. Politika publike luan një rol vendimtar në vendosjen e shinave për të gjitha zhvillimet. Mjedi social-ekonomik që qeveria mund të sigurojë, afekton potencialin e çdo ndërmarrje. Infrastruktura e duhur, një mjedi i përshtatshëm ligjor dhe mbështetja financiare janë vetëm disa elementë që qeveria mund të realizojë.

Bazuar në shtyllat e përcaktuara në këtë strategji, janë vendosur disa masa të cilat janë të lidhura me nismën që synohet të ndërmerret nga qeveria dhe që përfshijnë:

Masat prioritare

1. Ndërtimi i instrumenteve alternativë të financimit.
2. Tërheqja e fondeve ndërkombëtare dhe diasporës.
3. Masat e Financimit Alternativ – për të ndihmuar në krijimin e mbështetjes së strukturuar financiare dhe efikase për sipërmarrësit.

Për më tepër, kjo Strategji synon të përdorë mekanizmat kombëtarë të financimit dhe instrumentet e BE-së të disponueshme para anëtarësimit, për të krijuar infrastrukturën që mbështet bizneset e reja dhe sipërmarrësit.

Në strategji përcaktohet ndërtimi i instrumenteve të financimit.

Forcimi i rolit të sektorit publik si katalizator për investime me ndikim. Kjo do të bëhet përmes zhvillimit të një strategjie në përputhje me ato ekzistuese në vende të tjera si Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Estonia, edhe përmes mobilizimit të fondeve publike. Këto fonde publike do të synojnë të rrisin ose të drejtojnë investimet dhe financimin aktual drejt projekteve të trefishta që gjenerojnë ndikim.

Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Deri më tani, përpjekjet e ndërmarra nga autoritetet shqiptare kanë përfshirë: (i) përcaktimin e një kuadri rregullator fillestar për mbështetjen e NVM-ve dhe projekteve strategjike, përmes granteve dhe garancive sovraane, të cilat janë materializuar në disa vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave; (ii) krijimin e disa mekanizmave bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare, për të lehtësuar huamarrjen koncesionale dhe për të përforcuar kapacitetet vendase në sigurimin e fondeve afatgjata; (iii) iniciimin e disa programeve pilot të subvencioneve ose kredive të buta, të shtrira kryesisht në bujqësi, manifakturë dhe sektorin e fasonerisë, por edhe në nisma të vogla inovative (start-up), të cilat, megjithëse rezultative në aspektin vendor, mbeten ende të

kufizuara në shtrirje; (iv) zgjerimin e dialogut institucional ndërmjet ministrive kyçe, agjencive publike dhe partnerëve të huaj për të identifikuar sektorët me prioritet të lartë zhvillimor, ku kërkohen ndërhyrje financiare të strukturuar. Pavarësisht këtij progresi, analizat tregojnë se mbetet një hendek i konsiderueshëm ndërmjet nevojave aktuale të tregut dhe kapacitetit të instrumenteve ekzistuese për të ofruar mbështetje afatgjatë dhe të qëndrueshme.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi kryesor i politikës për krijimin e BZH është adresimi i sfidave të mungesës së financimit për sektorët strategjikë dhe përmirësimi i aksesit në kapital për bizneset shqiptare.

Ky objektivi i përgjithshëm mbështet një sërë synimesh specifike që lidhen drejtpërdrejt me problemet dhe boshllëqet e identifikuar në tregun financiar shqiptar, në përputhje me vizionin strategjik të qeverisë për zhvillimin ekonomik dhe integrimin në tregjet ndërkombëtare.

- Krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të specializuar për financimin e zhvillimit
- Mbështetja e NVM-ve dhe startup-eve për të përmirësuar aksesin në financim
- Ofrimi i kredidhënies së lehtësuar për sektorët prioritarë dhe lehtësimi i aksesit në fondet ndërkombëtare, brenda vitit 2027.
- Ndërtimi i një strukture financiare që mobilizon kapitalin privat dhe fondet ndërkombëtare për investime afatgjata në sektorë strategjikë, brenda vitit 2028
- Harmonizimi me praktikën më të mira evropiane në ndërtimin e një institucioni të besueshëm financiar;
- Rritja e kredive të garantuara të BZH me 2,2 % brenda vitit 2027 në 9% brenda vitit 2030

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni i status quo-së nuk adreson mungesën e një mekanizmi të specializuar për financimin e projekteve zhvillimore dhe nuk përmirëson aksesin në kapital për bizneset shqiptare. Pa një ndërhyrje institucionale, tregu financiar do të mbetet i fragmentuar dhe i varur nga burimet tradicionale të kreditimit, duke penguar rritjen e sektorëve strategjikë dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë.

Aktualisht, ekonomia shqiptare përballlet me sfida të mëdha në sigurimin e financimeve për sektorë kyç si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, bujqësia, turizmi, infrastruktura dhe inovacioni. Bankat tregtare ndjekin një model kredidhënieje konservator, duke favorizuar sektorët me rrezik të ulët dhe duke kufizuar mundësitë për bizneset e reja ose ato që nuk kanë kolateral të mjaftueshëm. Kjo situatë ka krijuar një boshllëk të konsiderueshëm financimi, veçanërisht për NVM-të dhe startup-et, të cilat përballen me barriera të larta për akses në kredi dhe mungesë mbështetjeje nga investitorët privatë. Po ashtu, bujqësia dhe turizmi, megjithëse me rëndësi strategjike për

ekonominë, mbeten të nënfinancuar për shkak të rrezikut të lartë të perceptuar nga bankat, mungesës së sigurimeve dhe infrastrukturës së papërshtatshme. Investimet në infrastrukturë janë të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e vendit në transport, energji dhe digitalizim, ndërkohë që kufizimet fiskale dhe sfidat në zbatimin e PPP-ve e vështirësojnë më tej financimin e projekteve strategjike. Mungesa e mbështetjes financiare është veçanërisht e ndjeshme në zonat rurale, ku bizneset përballen me infrastrukturë të dobët, mungesë shërbimesh financiare dhe vështirësi për të tërhequr investime.

Në këtë kontekst, opsioni i status quo-së nuk mund të adresojë këto problematika, pasi mungesa e një mekanizmi të specializuar për financimin e projekteve zhvillimore dhe rritjen e aksesit në kapital do të vazhdojë të frenojë zhvillimin ekonomik afatgjatë. Për këtë arsye, krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit do të ishte një zgjidhje e rëndësishme, duke mundësuar kanalizimin e fondeve shtesë drejt sektorëve strategjikë, mobilizimin e kapitalit privat dhe përmirësimin e koordinimit mes qeverisë dhe sektorit financiar. Një institucion i tillë do të ndihmonte në adresimin e boshllëqeve të tregut, rritjen e financimeve për projekte me ndikim afatgjatë dhe sigurimin e një zhvillimi më të ekuilibruar ekonomik në të gjithë vendin.

Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.

Në procesin e hartimit të politikës për krijimin e BZH u shqyrtuan disa opsione për të adresuar sfidat e identifikuar në sistemin financiar dhe për të përmbushur objektivat strategjike të qeverisë. Përveç mbajtjes së status quo-së, e cila u konsiderua e pamjaftueshme për të kapërcyer kufizimet aktuale, u vlerësua gjithashtu edhe opsioni jo-rregullator, i cili përfshinte forcimin dhe optimizimin e skemave ekzistuese të mbështetjes financiare për NVM-të dhe projektet strategjike, pa krijuar një entitet të ri financiar si dhe u analizua opsioni kryesor i hartimit të një ligji të ri për krijimin e BZH.

Opsioni 1 (jo-rregullator): Forcimi i Skemave Ekzistuese të Mbështetjes Financiare

Qeveria ka përdorur tradicionalisht një kombinim të mbështetjes buxhetore, granteve dhe garancive sovrane për të ndihmuar zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe për të financuar projekte strategjike. Mbështetja për NVM-të është realizuar kryesisht përmes skemave të financimit që synojnë sektorë si bujqësia, manifaktura, fasoneria dhe startup-et inovative, duke u mundësuar këtyre bizneseve akses në grante dhe kredi të subvencionuara. Nga ana tjetër, financimi i projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore është bërë kryesisht përmes buxhetit të shtetit dhe në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat kanë ofruar kredi të buta dhe grante për projekte me ndikim strategjik.

Megjithëse këto mekanizma kanë ofruar një nivel mbështetjeje, ato kanë qenë të kufizuara nga burimet e disponueshme dhe nuk kanë siguruar një model të qëndrueshëm afatgjatë për financimin e sektorëve strategjikë. Për këtë arsye, një opsion alternativ jo-rregullator do të ishte forcimi dhe zgjerimi i skemave ekzistuese të financimit për NVM-të dhe projektet infrastrukturore, duke rritur fondet e dedikuara dhe duke përmirësuar mekanizmat e menaxhimit të tyre. Ky opsion do të përfshinte përmirësimin e qasjes në financa përmes modifikimit të kushteve të ekzistuese të

garancive sovrane dhe kredive të buta, si dhe rritjen e fleksibilitetit të instrumenteve ekzistuese për t'u përshtatur më mirë me nevojat e sektorëve me potencial zhvillimi.

Ky opsion ka disa avantazhe që e bëjnë atë një alternativë më të lehtë për t'u zbatuar në afat të shkurtër. Së pari, ai shmang krijimin e një institucioni të ri, duke mbështetur mekanizmat ekzistues pa nevojën për të ngritur një entitet të ri financiar. Kjo do të thotë se nuk do të kërkohej një proces i gjatë rregullator dhe institucional për themelimin e një banke të re zhvillimi. Gjithashtu, ky opsion ka një kosto më të ulët fillestare për qeverinë, pasi nuk kërkon kapitalizim të madh, i cili do të ishte i nevojshëm nëse do të krijohesh një bankë zhvillimi. Përdorimi i përvojës dhe strukturave ekzistuese është një tjetër përparësi, pasi skemat aktuale të financimit mund të modifikohen dhe të përshtaten për të përmirësuar aksesin në kapital për bizneset, duke ofruar mbështetje më të drejtpërdrejtë dhe të synuar. Për më tepër, ky opsion mund të zbatohet më shpejt, duke shmangur nevojën për ndryshime të thella ligjore dhe krijimin e një entiteti të ri financiar, çka e bën atë një zgjidhje që mund të vihet në funksion në një periudhë më të shkurtër kohe.

Megjithatë, ky opsion ka edhe kufizime të rëndësishme që e bëjnë më pak të përshtatshëm për një qasje afatgjatë dhe të qëndrueshme në financimin e sektorëve strategjikë. Një nga disavantazhet kryesore është mungesa e një mekanizmi të qëndrueshëm afatgjatë, pasi financimi do të mbetet i varur nga burimet publike dhe donatorët ndërkombëtarë, pa një model të vetëfinancuar që mund të sigurojë vazhdimësinë e mbështetjes financiare. Po ashtu, ky opsion nuk ofron kapacitet për kredidhënie të drejtpërdrejtë, ndryshe nga një bankë zhvillimi, e cila do të krijonte një strukturë të dedikuar për të dhënë kredi me kushte të përshtatshme për bizneset që nuk kanë akses të lehtë në financim. Për më tepër, ai nuk adreson plotësisht boshllëkun e madh të financimit, pasi skemat ekzistuese nuk janë të dizajnuara për të mbuluar nevojën për kredi afatgjata dhe investime madhore, të cilat janë të domosdoshme për të nxitur rritjen ekonomike dhe modernizimin e sektorëve kyç. Një tjetër sfidë e këtij opsioni është burokracia dhe fragmentimi i fondeve, pasi financimi do të vazhdojë të shpërndahet nëpër mekanizma të ndryshëm, duke krijuar pengesa administrative dhe vonesa në aksesimin e fondeve nga bizneset. Për shkak të këtyre kufizimeve, ky opsion mbetet një zgjidhje e pjesshme dhe e kufizuar për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Opsioni 2: Propozimi i një ligji të ri për Bankën e Zhvillimit

Opsioni për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) përmes një ligji të ri synon të adresojë në mënyrë të plotë dhe afatgjatë sfidat e financimit në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare. Përmes këtij opsioni, do të krijohesh një institucion financiar i specializuar, i cili do të kishte mandatin të mbështeste zhvillimin ekonomik dhe social të vendit duke ofruar financime, garanci dhe instrumente të tjera financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), projektet infrastrukturore dhe sektorët me rëndësi strategjike.

Një ndër avantazhet kryesore të krijimit të BZH-së është që ajo do të siguronte një mekanizëm të qëndrueshëm dhe afatgjatë të financimit, i cili nuk do të varej ekskluzivisht nga fondet publike, por do të mund të mobilizonte kapital privat dhe të tërhiqte investime nga institucionet financiare ndërkombëtare. Ndryshe nga skemat e fragmentuara të financimit, të cilat shpesh burojnë nga fonde të kufizuara të qeverisë apo nga programe të donatorëve, një bankë zhvillimi do të kishte një

strukturë të pavarur financiare dhe do të operonte sipas praktikave më të mira ndërkombëtare për Bankat Promovuese Kombëtare.

Për më tepër, krijimi i BZH-së do të lejonte dhënien e kredive afatgjata me kushte të favorshme, duke mbushur hendekun që ka ekzistuar në sistemin financiar shqiptar, ku bankat tregtare janë orientuar kryesisht drejt kredive afatshkurtra dhe me norma interesi relativisht të larta. Përmes këtij mekanizmi, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të kishin një burim të sigurt financimi për investime të rëndësishme, të cilat do të ndikonin në rritjen e tyre dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë në tregjet vendase dhe ndërkombëtare.

Një tjetër përfitim i rëndësishëm i këtij opsioni është që BZH do të kishte kapacitetin të vepronte si një institucion koordinues midis qeverisë, bankave tregtare, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe sektorit privat. Kjo do të mundësonte një përdorim më efektiv të burimeve ekzistuese financiare dhe do të ndihmonte në reduktimin e fragmentimit dhe burokracisë që shpesh pengon qasjen e bizneseve dhe projekteve infrastrukturore në financim.

Një tjetër element kyç është fakti që BZH do të kishte fleksibilitet më të lartë në ofrimin e instrumenteve të ndryshme financiare, duke përfshirë jo vetëm kredi, por edhe garanci, fonde investimi dhe mekanizma të përzier të financimit. Kjo do të mundësonte një qasje më gjithëpërfshirëse për financimin e sektorëve strategjikë, duke përmirësuar ndjeshëm mjedisin e investimeve në Shqipëri dhe duke nxitur një zhvillim më të balancuar ekonomik.

Ndërsa krijimi i një banke zhvillimi ka avantazhe të rëndësishme afatgjata, ky opsion ka edhe disa sfida që duhet të merren parasysh. Së pari, ai kërkon një kapital fillestar të konsiderueshëm nga qeveria, i cili mund të shtrihet në disa vite për të siguruar një bazë të qëndrueshme financiare për operacionet e bankës. Megjithatë ky kapital mund të sigurohet pjesërisht nga fondet publike dhe donatorët ndërkombëtarë, ai përbën një angazhim të rëndësishëm financiar për shtetin.

Një tjetër sfidë e mundshme është procesi i gjatë i krijimit të institucionit të ri, i cili kërkon miratimin e një kuadri të plotë ligjor dhe rregullator, si dhe ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme administrative dhe teknike për funksionimin e tij. Krahës kësaj, do të jetë e nevojshme të përcaktohet një mekanizëm i qartë mbikëqyrjeje dhe qeverisjeje për të siguruar që banka të operojë në mënyrë transparente dhe efikase, në përputhje me standardet më të mira të qeverisjes financiare.

Për më tepër, BZH mund të përballë me sfidën e balancimit midis mandatit të saj zhvillimor dhe detyrimeve për të ruajtur stabilitetin financiar, pasi do të duhet të sigurojë që operacionet e saj të jenë të qëndrueshme dhe të mos krijojnë rreziqe të larta fiskale për qeverinë. Ky është një faktor që do të kërkojë një menaxhim të kujdesshëm të riskut dhe përcaktimin e kriterëve të qarta për financimin e projekteve.

Pavarësisht sfidave të mundshme në zbatimin e këtij opsioni, propozimi i një ligji të ri për krijimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit është opsioni më i përshtatshëm, pasi ai ofron një mekanizëm të qartë dhe të qëndrueshëm për financimin e sektorëve strategjikë. Ndryshe nga opsionet e tjera të shqyrtuara, të cilat mbeten të kufizuara në fondet ekzistuese dhe skemat e fragmentuara, një bankë

zhvillimi do të krijonte një strukturë të dedikuar për të adresuar nevojat financiare të ekonomisë shqiptare, duke siguruar një burim të pavarur dhe afatgjatë financimi.

Ky vendim u mbështet nga konsultime të gjera me aktorë kyç vendas dhe ndërkombëtarë, përfshirë Cassa Depositi e Prestiti (CDP) të Italisë, e cila ka ofruar ekspertizë të vlefshme në konceptimin e BZH-së. Përvoja ndërkombëtare tregon se krijimi i një banke zhvillimi është një praktikë e suksesshme për të mbushur boshllëqet e tregut dhe për të nxitur investimet në sektorë kyç. Për këtë arsye, ky opsion është vlerësuar si më i përshtatshmi për një model të qëndrueshëm të financimit të zhvillimit në Shqipëri, duke harmonizuar praktikat më të mira ndërkombëtare dhe duke siguruar një strukturë të fortë institucionale për mbështetjen e ekonomisë shqiptare.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përsbikruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
- *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përsbikruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuar.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuar krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) pritet të ketë ndikime të rëndësishme në disa grupe kryesore të interesit:

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe startup-et

Ky grup është fokusi kryesor i BZH-së. NVM-të shpesh përballen me mungesë financimesh për shkak të normave të larta të interesit dhe kërkesave për kolateral nga bankat tregtare. BZH do të ndihmojë NVM-të dhe startup-et duke ofruar garanci dhe kredi me kushte të favorshme, duke rritur aksesin e tyre në financime. Këto biznese do të kenë mundësinë të zhvillohen dhe të rrisin konkurrencën e tyre në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

Qeveria dhe institucionet publike

BZH do të reduktojë varësinë e qeverisë nga buxheti i shtetit për financimin e projekteve strategjike, duke siguruar një mekanizëm të qëndrueshëm për bashkëfinancimin e projekteve publike. Përmes këtij institucioni, qeveria do të mund të mobilizojë më lehtë fondet e donatorëve ndërkombëtarë dhe të përthithë financime nga Bashkimi Evropian për zhvillimin e infrastrukturës dhe sektorëve prioritarë të ekonomisë.

Investitorët privatë dhe tregu financiar

Përmes bashkëpunimit me bankat tregtare dhe përdorimit të instrumenteve të garantimit të kredive, BZH do të luajë një rol kyç në mobilizimin e kapitalit privat. Kjo do të krijojë një mjedis më të favorshëm për investitorët, duke nxitur rritjen e tregut financiar dhe duke forcuar lidhjet mes sektorit publik dhe atij privat në financimin e projekteve strategjike.

Ndikimet e drejtpërdrejta

Krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) pritet të sjellë ndikime të dukshme të drejtpërdrejta në grupe të ndryshme interesi, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e qasjes në financa për sektorët kyç. Më poshtë detajohen ndikimet kryesore cilësore dhe sasiore.

Ndikimet ekonomike

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe startup-et

Me BZH, këto biznese do të kenë mundësi të marrin kredi me kushte më të favorshme dhe të përfitojnë garanci për financimet e tyre. Kjo mbështetje do të ndihmojë NVM-të të:

- Rrisin kapacitetet prodhuese, duke investuar në teknologji të reja dhe përmirësimin e proceseve të tyre.
- Zgjerojnë aktivitetet e tyre, si në tregun vendas ashtu edhe në tregjet ndërkombëtare.
- Përmirësojnë konkurrencën, duke qenë në gjendje të ofrojnë produkte dhe shërbime më cilësore me çmime më të mira.

BZH do të krijojë produkte të dedikuara për start-up-et, duke nxitur inovacionin dhe zhvillimin teknologjik. Këto biznese, që shpesh konsiderohen me rrezik të lartë nga bankat tregtare, do të kenë një partner të besueshëm që do të ofrojë financime të përshtatura për idetë dhe projektet e tyre. Mbështetja për start-up-et do të ndihmojë në:

- Diversifikimin e ekonomisë, duke zhvilluar sektorë të rinj si teknologjia, energjia e gjelbër dhe bujqësia e zgjuar.
- Krijimin e vendeve të reja të punës, veçanërisht për të rinjtë dhe profesionistët me aftësi të larta.
- Nxitjen e inovacionit, duke mundësuar zhvillimin e zgjidhjeve të reja dhe produkteve teknologjike.

Qeveria dhe institucionet publike:

- Ndikimi mbi qeverinë dhe institucionet publike në fazën fillestare do të jetë indirekt, duke u fokusuar kryesisht në mbështetjen e NMV-ve si shtyllë kryesore e ekonomisë. Megjithatë, në afat të gjatë, BZH do të ndihmojë qeverinë të mobilizojë fonde ndërkombëtare për projekte strategjike dhe zhvillimore.
- Për shembull, përmes bashkëpunimit me institucionet si BEI dhe BERZH, qeveria do të jetë në gjendje të zhvillojë projekte infrastrukturore me ndikim kombëtar.

Investitorët Privatë dhe Tregu Financiar:

- Përmes instrumenteve të garantimit të kredive dhe bashkëpunimit me bankat tregtare, BZH do të reduktojë rrezikun për investitorët privatë dhe do të nxisë investimet në sektorë strategjikë.
- Investitorët privatë do të kenë mundësi të bashkëpunojnë me BZH për të financuar projekte të rëndësishme zhvillimore, duke përfituar nga skemat e bashkëfinancimit dhe garancitë e kredisë.
- Përmes diversifikimit të burimeve të financimit dhe krijimit të instrumenteve të reja financiare, BZH do të ndihmojë në stabilizimin e tregut financiar dhe në rritjen e besimit të investitorëve ndërkombëtarë.
- Duke bashkëpunuar ngushtë me bankat private, BZH do të ndihmojë në plotësimin e boshllëqeve të tregut dhe në rritjen e efikasitetit të sistemit financiar.

Ndikime Sasiore

1. Kapitali fillestar:

Kapitali fillestar prej **10 miliardë lekësh**, i alokuar nga buxheti i shtetit, do të sigurojë bazën financiare të BZH-së për të nisur operacionet e saj. Kjo shumë do të përdoret për të:

- Krijuar fondin fillestar për ofrimin e kredive dhe garancive për NMV-të dhe start-up-et.
- Financuar projekte prioritare që kanë ndikim të menjëhershëm në ekonominë kombëtare.
- Mbështetur funksionimin administrativ dhe operacional të bankës në fazat e para.

2. Ndikimi mbi NMV-të dhe dhe startup-et

Pritet që gjatë viteve të para të funksionimit, BZH të mbështesë qindra NMV dhe start-up-e, duke siguruar:

- Ofrimi i kredive me kushte të favorshme dhe garancive do të ndihmojë këto ndërmarrje të realizojnë projekte të reja zhvillimore.
- Financimet do të përqendrohen në sektorë strategjikë si bujqësia, turizmi, teknologjia dhe energjia, të cilët kanë potencial për të kontribuar në rritjen e qëndrueshme të ekonomisë shqiptare.

3. Mobilizimi i Kapitalit Privat

Përmes instrumenteve të garantimit dhe bashkëfinancimeve, BZH synon të mobilizojë një përqindje të konsiderueshme të kapitalit privat për projekte strategjike. Ky mobilizim do të shumëfishojë ndikimin e kapitalit fillestar të bankës.

Financimet që do të ofrojë Banka Shqiptare e Zhvillimit (BZH) pritet të ndihmojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV) të zgjerojnë aktivitetet e tyre në tregjet ndërkombëtare, duke rritur kapacitetin për eksport dhe përmirësuar balancën tregtare të vendit. Kapitali fillestar prej 10 miliardë lekësh, i alokuar nga buxheti i shtetit, do të shërbejë si bazë për të gjeneruar një kthim afatgjatë, duke fuqizuar produktivitetin e NMV-ve dhe duke kontribuar në përmirësimin e ekonomisë kombëtare. Përmes këtij investimi strategjik, përfitimet monetare dhe sociale pritet të tejkalojnë koston fillestare, duke ofruar një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Për më tepër, mbështetja e dedikuar për start-up-et dhe projektet inovative do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më konkurrues dhe të sofistikuar ekonomik, duke forcuar pozitën e Shqipërisë në tregjet rajonale dhe duke e bërë atë një destinacion më tërheqës për investimet ndërkombëtare. Këto përfitime janë të ndjeshme dhe të prekshme për një gamë të gjerë aktorësh ekonomikë dhe socialë, duke kontribuar në një zhvillim më të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) pritet të ketë një ndikim të gjerë dhe të rëndësishëm edhe përtej përfitimeve të drejtpërdrejta. Ndikimet jo të drejtpërdrejta përfshijnë përmirësimin e konkurrencës në tregun vendas dhe ndërkombëtar, nxitjen e zhvillimit rajonal dhe social, si dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe ekonomike të Shqipërisë.

- **Forcimi i konkurrencës ekonomike:** Përmes garantimit të financimeve dhe bashkëpunimit me bankat tregtare, BZH do të ndihmojë bizneset shqiptare të bëhen më konkurruese në tregjet ndërkombëtare.
- **Besimi i partnerëve ndërkombëtarë:** Krijimi i një banke zhvillimi do të rrisë besimin e investitorëve të huaj dhe institucioneve ndërkombëtare financiare për të bashkëpunuar me Shqipërinë.
- **Reduktimi i fragmentimit financiar:** BZH do të harmonizojë politikat e mbështetjes financiare për bizneset, duke ndihmuar në koordinimin më të mirë të fondeve publike dhe private për zhvillimin ekonomik të vendit.

Analiza e ndikimit

Konkurrenca në tregun financiar

- BZH nuk do të konkurrojë drejtpërdrejt me bankat tregtare, por do të plotësojë boshllëqet ekzistuese në treg duke mbështetur sektorë dhe projekte që bankat private i konsiderojnë si të rrezikshme ose me fitime të ulëta.
- Duke bashkëpunuar me bankat tregtare për ofrimin e financimeve dhe garancive, BZH do të krijojë një mjedis më të shëndetshëm dhe më efikas financiar, duke nxitur një ekosistem konkurrues në treg.

Konkurrenca ndërmjet ndërmarrjeve

- Me akses më të lehtë në financa, NMV-të do të jenë në gjendje të përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre, duke u bërë më konkurruese në tregun vendas dhe ndërkombëtar.

- Mbështetja për start-up-et do të krijojë një mjedis inovativ dhe konkurrues, duke nxitur zhvillimin e sektorëve të rinj ekonomikë.

Kontributi në tregjet ndërkombëtare

- Me rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe mbështetjen për hyrjen në tregjet ndërkombëtare, NMV-të do të kontribuojnë në rritjen e eksporteve shqiptare, duke përmirësuar pozitën e vendit në tregjet rajonale dhe globale.

Rritja e investimeve private

- Përmes skemave të bashkëfinancimit dhe garantimit të kredive, BZH do të tërheqë më shumë kapital privat për të mbështetur projekte strategjike, duke krijuar një konkurrencë më të fortë në sektorët ekonomikë.

Kufizimet e analizës

Analiza e ndikimeve bazohet në disa supozime kryesore, përfshirë vullnetin e bankave tregtare për të bashkëpunuar me BZH dhe angazhimin e qeverisë për të siguruar mbështetje ligjore dhe institucionale. Rreziqet përfshijnë vonesat në zbatimin e projektit, sfidat në menaxhimin e fondeve dhe nevojën për kapacitete të larta administrative për të siguruar efikasitetin e operacioneve të bankës.

Vlerësimi i Ndikimit Gjinator (VNGj)

Ky vlerësim gjinator synon të analizojë ndikimin e projektligjit "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit" (BZH) në barazinë gjinore dhe promovimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në sektorin financiar dhe ekonomik. Banka e Zhvillimit ka për qëllim të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, duke krijuar mundësi financimi për sektorët e nënfinancuar dhe duke mbështetur projekte zhvillimore. Kështu, një analizë gjinore është thelbësore për të siguruar që dispozitat e ligjit nuk krijojnë pabarazi dhe kontribuojnë në fuqizimin ekonomik të grave.

Analiza e Gjendjes Aktuale

Në Shqipëri, pavarësisht progresit të bërë në drejtim të barazisë gjinore, gratë vazhdojnë të përballen me sfida të konsiderueshme në aksesin në financa, veçanërisht për sa i përket kredive dhe investimeve për bizneset e vogla dhe të mesme. Të dhënat tregojnë se ndërmarrjet në pronësi të grave kanë më pak akses në financim të jashtëm, për shkak të mungesës së kolateralit dhe normave të ndryshme të miratimit të kredive nga institucionet financiare.

Në këtë kontekst, krijimi i Bankës Shqiptare të Zhvillimit paraqet një mundësi për të integruar perspektivën gjinore në politikat dhe praktikatat financiare të vendit.

Ndikimi i projektligjit në barazinë gjinore

Projektligji për BZH ka potencial për të ndikuar pozitivisht në barazinë gjinore përmes politikave dhe instrumenteve të financimit që favorizojnë pjesëmarrjen e grave në ekonomi.

Këto ndikime përfshijnë:

Përmirësimin e Aksesit të Grave në Financim: BZH mund të krijojë mekanizma specifike për të mbështetur bizneset në pronësi të grave përmes skemave të garancive ose linjave të dedikuara të financimit.

Nxitja e Sipërmarrjes së Grave: Ligji mund të parashikojë masa të veçanta për promovimin e sipërmarrjes femërore, duke mbështetur start-up-et dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë.

Ndikimi në Punësim dhe Rritjen Ekonomike: Mbështetja e projekteve zhvillimore me një qasje gjithëpërfshirëse mund të rrisë punësimin e grave në sektorë të ndryshëm ekonomikë.

Përfshirja në vendimmarrje: Strukturat drejtuese të BZH mund të reflektojnë përfaqësimin e balancuar gjinor, duke garantuar se gratë marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes ekonomike.

Rekomandime për përmirësimin e ndikimit gjinor

Për të siguruar që projektligji "Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit" kontribuon në mënyrë efektive në barazinë gjinore, synhen këto masa:

- zhvillimi i programeve të financimit të dedikuar për gratë: përfshirja e linjave të posaçme të kredive dhe garancive financiare për bizneset e grave.
- vendosja e kuotave për përfaqësimin gjinor në strukturat drejtuese të bzh: krijimi i mekanizmave për të garantuar përfaqësim të barabartë gjinor në bordet dhe drejtimin e institucionit.
- monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit gjinor: vendosja e treguesve për matjen e ndikimit të bzh mbi përmirësimin e aksesit të grave në financim dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në ekonomi.
- trajnime dhe fushata ndërgjegjësimi: organizimi i trajnimeve për stafin dhe aktorët e përfshirë për të promovuar praktika të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor.
- bashkëpunim me institucione dhe organizatave që promovojnë barazinë gjinore: përfshirja e aktorëve kyç për të siguruar që banka e zhvillimit i përgjigjet nevojave specifike të grave sipërmarrëse dhe të punësuar në sektorë të ndryshëm.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Për të vlerësuar opsionet e marra në konsideratë, është aplikuar Analiza me shumë kritere, një metodë e cila mundëson krahasimin e alternativave në bazë të disa faktorëve të paracaktuar, duke siguruar një vlerësim të plotë dhe objektiv të ndikimit të secilit opsion. Kjo metodë lejon një analizë të detajuar të faktorëve kyç që ndikojnë në efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e politikës së propozuar, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë financiare, ndikimin afatgjatë në zhvillimin ekonomik dhe përputhshmërinë me praktikën ndërkombëtare.

Kriteret kryesore të përdorura për vlerësimin e opsioneve janë:

1. Qëndrueshmëria financiare – aftësia e opsionit për të krijuar një mekanizëm të qëndrueshëm dhe të vetëfinansuar.

2. Efektiviteti në adresimin e boshllëqeve të tregut – ndikimi në financimin e sektorëve të nënpërfaqësuar, si NVM-të, bujqësia, turizmi dhe infrastruktura.
3. Koordinimi institucional dhe ulja e fragmentimit – aftësia për të siguruar një mekanizëm të integruar dhe të pavarur nga ciklet buxhetore vjetore.
4. Ndikimi afatgjatë në zhvillimin ekonomik – kontributi në nxitjen e investimeve, punësimin dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë.
5. Përshtatshmëria me praktikën më të mira ndërkombëtare – harmonizimi me standardet e BE-së dhe eksperiencën e vendeve të tjera me banka zhvillimi.
6. Kosto-efektiviteti – vlerësimi i kostove fillestare dhe përfitimeve në raport me opsionet e tjera.

Kriteret e vlerësimit	Opsioni (Status Quo)	Opsioni 1 (Forcimi i Skemave Ekzistuese të Mbështetjes Financiare)	Opsioni 2 (Propozimi i një ligji të ri për Bankën e Zhvillimit)
Qëndrueshmëria financiare	E ulët – varet nga fondet buxhetore dhe donatorët	E kufizuar – nuk siguron një mekanizëm vetëfinansimi	E lartë – siguron një mekanizëm të pavarur dhe afatgjatë
Efektiviteti në adresimin e boshllëqeve të tregut	I pamjaftueshëm – financimi mbetet i fragmentuar	I kufizuar – mund të mbulojë disa sektorë, por nuk jep financim afatgjatë	I lartë – mbështet sektorët strategjikë dhe adreson mungesën e kapitalit
Koordinimi institucional dhe ulja e fragmentimit	I ulët – financimi kalon përmes skemave të shpërndara	I moderuar – mund të përmirësohet përmes modifikimeve, por mbetet i fragmentuar	I lartë – krijon një qendër të specializuar financimi dhe ul fragmentimin
Ndikimi afatgjatë në zhvillimin ekonomik	I ulët – nuk ka ndërhyrje strukturore	I moderuar – mund të ndihmojë disa sektorë, por jo në mënyrë sistematike	I lartë – siguron financim afatgjatë për rritjen ekonomike
Përshtatshmëria me praktikën ndërkombëtare	Nuk harmonizohet me praktikën e BE-së	I moderuar – përputhet me disa modele, por nuk është i krahasueshëm me NPB-të evropiane	I lartë – në përputhje me modelet e BE-së dhe praktikën më të mira ndërkombëtare
Kosto-efektiviteti	Nuk ka kosto shtesë, por nuk zgjidh problemet	Kosto e ulët fillestare, por impakt i kufizuar	Kërkon investim fillestar, por siguron përfitime afatgjata

Përfitimet e opsionit të preferuar

1. Sigurimi i një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të pavarur financimi

Ndryshe nga opsionet e tjera, BZH do të krijojë një mekanizëm të pavarur për financimin afatgjatë të projekteve strategjike dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Banka do të ketë aftësinë të mobilizojë burime financiare nga sektori privat dhe nga institucionet ndërkombëtare, duke reduktuar varësinë nga fondet publike.

2. Adresimi i boshllëqeve të tregut

BZH do të ofrojë produkte të përshtatura financiare, të cilat mungojnë në tregun aktual, duke siguruar kredi afatgjata, garanci dhe instrumente të financimit të kombinuar (blended finance). Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e aksesit në kapital për sektorët e nënpërfaqësuar si bujqësia, turizmi dhe NVM-të.

3. Harmonizimi me praktikat më të mira ndërkombëtare

Modelet e suksesshme të Cassa Depositi e Prestiti (CDP) në Itali, Bpifrance në Francë dhe HBOR në Kroaci tregojnë se një bankë zhvillimi mund të jetë një instrument kyç për tërheqjen e investimeve dhe mbështetjen e rritjes ekonomike. Krijimi i BZH-së është plotësisht në përputhje me Komunikimin e Komisionit Evropian COM (2015) 361 final, i cili vendos bankat zhvillimore në qendër të strategjive kombëtare për financimin e projekteve infrastrukturore dhe inovacionit.

4. Ulja e fragmentimit të financimeve dhe rritja e efikasitetit institucional

Një nga sfidat e sistemit aktual është shpërndarja e fondeve nëpër skema të ndryshme me efikasitet të kufizuar. BZH do të shërbejë si një mekanizëm qendror i koordinuar që lehtëson aksesin në financa dhe siguron një proces më transparent dhe të thjeshtëzuar për përfituesit.

Përfundimi

Në përfundim, bazuar në analizën e shumëfishtë të kriterëve të vlerësimit, Propozimi i një ligji të ri për Bankën e Zhvillimit është opsioni më i përshtatshëm për të mbështetur rritjen ekonomike të vendit. Ky opsion jo vetëm që siguron një mekanizëm të pavarur dhe të qëndrueshëm financimi, por gjithashtu përputhet me praktikat më të mira ndërkombëtare, ofron një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave të tregut dhe garanton ndikim afatgjatë në sektorët strategjikë të ekonomisë.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përsërkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Qeveria do të luajë një rol kyç në fazën e parë të operimit të BZH, duke siguruar që fondet publike të përdoren në mënyrë efektive dhe që mekanizmat e financimit të vendosen mbi baza të qëndrueshme. Gjithashtu, do të krijohen mekanizma për bashkëpunim me bankat tregtare dhe institucionet financiare ndërkombëtare, për të shmangur mbivendosjen e funksioneve dhe për të garantuar një sistem kreditimi plotësues e jo konkurrues.

Për zbatimin e BZH-së, përgjegjësitë do të ndahen midis institucioneve kryesore që mbulojnë aspektet e krijimit dhe funksionimit të bankës:

Ligji dhe qeverisja

- Ministria e Financave do të jetë përgjegjëse për kapitalizimin fillestar të BZH-së, monitorimin e operacioneve financiare dhe integrimin e bankës me politikën fiskale dhe të investimeve.
- Banka e Shqipërisë do të ketë rol këshillues dhe bashkëpunues, duke siguruar përputhjen e

veprimtarisë së BZH-së me politikat monetare dhe financiare të vendit. Marrëdhënia ndërmjet BZH-së dhe Bankës së Shqipërisë do të rregullohet përmes një marrëveshjeje të përbashkët, që do të përcaktojë mekanizmat e raportimit dhe monitorimit.

Financimi dhe burimet financiare

- Ministria e Financave – do të sigurojë kapitalin fillestar prej 10 miliardë lekësh.
- BZH do të angazhohet në mobilizimin e fondeve, nga Institucionet Financiare ndërkombëtare dhe investitorët private.

Menaxhimi i rrezikut dhe mbikëqyrja

- Banka e Shqipërisë do të bashkëpunojë me BZH për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të rrezikut, duke shmangur destabilizimin e tregut financiar vendas.

Pengesat e mundshme për zbatimin e BZH-së

- Mungesa e një kuadri të mëparshëm për një institucion të tillë – Si një bankë zhvillimi, BZH është një koncept i ri për tregun shqiptar dhe mund të ketë sfida në përshtatjen e saj me sistemin ekzistues financiar.
- Integrimi me sektorin privat dhe bankat tregtare – Bankat mund të jenë të kujdesshme në bashkëpunimin me BZH, veçanërisht për modelet e financimit indirekt dhe të garantuar.

1. Masat për të siguruar zbatimin e suksesshëm

Për të adresuar këto sfida, do të ndërmerren disa masa të rëndësishme:

- Krijimi i një kuadri të qartë rregullator për operationet e BZH-së – Përcaktimi i qartë i kufijve ndërmjet aktiviteteve promovuese dhe atyre tregtare për të shmangur çdo mbivendosje me sektorin bankar ekzistues.
- Forcimi i rolit bashkëpunues ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Shqiptare të Zhvillimit do të sigurohet përmes një mekanizmi të qëndrueshëm monitorimi. Në këtë kuadër, BZH do të raportojë rregullisht në Bankën e Shqipërisë për qëllime statistikore dhe për regjistrin e kredive, duke garantuar transparencën dhe përputhshmërinë me standardet financiare. Ky bashkëpunim do të forcojë mbikëqyrjen dhe koordinimin midis dy institucioneve, duke siguruar stabilitetin e sistemit financiar dhe efektivitetin e operacioneve të BZH-së.
- Përfshirja e partnerëve ndërkombëtarë – Donatorët si BERZH, IFC, BEI dhe KfW do të ndihmojnë në sigurimin e fondeve dhe ekspertizës për zhvillimin e mëtejshëm të bankës.
- Bashkëpunimi me sektorin privat – Krijimi i skemave të garantimit dhe bashkëfinancimit me bankat tregtare për të shmangur perceptimin e BZH-së si një konkurrent në tregun financiar.

2. Kërkesat për përputhshmërinë dhe zbatimin

BZH do të operojë sipas një regjimi të veçantë ligjor, i cili përjashton aplikimin e rregullave të zakonshme të bankave tregtare:

- Përjashtimi nga licencimi sipas ligjit për bankat – BZH nuk do të licencohet nga Banka e Shqipërisë dhe nuk do të funksionojë si bankë tregtare, por si një shoqëri aksionare me mbështetje shtetërore.
- Rregullimi përmes marrëveshjeve institucionale – Marrëdhënia e BZH-së me Bankën e Shqipërisë do të rregullohet përmes një marrëveshjeje të veçantë, që do të përcaktojë aspektet e monitorimit dhe raportimit financiar.
- Përcaktimi i mekanizmave të financimit – BZH do të përdorë një kombinim të financimeve publike dhe private, duke mobilizuar fonde nga BE, dhe institucionet e tjera financiare ndërkombëtare.
- Përcaktimi i rolit të qeverisë – Shteti do të mbajë një pjesëmarrje jo më të vogël se 51% në kapitalin aksionar të bankës për të siguruar që BZH të mbetet një instrument zhvillimor në shërbim të ekonomisë shqiptare.

BZH do të funksionojë si një institucion financiar i veçantë dhe jo si një bankë tregtare, duke operuar përmes një kuadri të dedikuar ligjor dhe në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë për çështjet e stabilitetit financiar dhe raportimit. Ky model synon të krijojë një mekanizëm efektiv për financimin e projekteve strategjike dhe për rritjen e aksesit në financa për sektorët e nënfinancuar të ekonomisë shqiptare.

Përmes këtij kuadri të qartë, BZH nuk do të jetë një konkurrent i drejtpërdrejtë i bankave tregtare, por një plotësues i tyre, duke siguruar financime afatgjata dhe mbështetje për bizneset që nuk kanë akses të mjaftueshëm në tregun tradicional bankar.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/ treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i progresit në zbatimin e reformës për krijimin dhe funksionimin e Bankës Shqiptare të Zhvillimit (BZH) do të realizohet përmes një kornize të qartë dhe të strukturuar, e cila do të sigurojë ndjekjen e vazhdueshme të zhvillimeve, identifikimin e sfidave dhe vlerësimin e ndikimit të ndërhyrjes. Ky proces do të mundësojë një analizë të rregullt të performancës së bankës dhe të përputhshmërisë së saj me objektivat strategjike të qeverisë, duke garantuar një qasje transparente dhe të llogaridhënies së lartë në menaxhimin e fondeve publike dhe private. Një aspekt thelbësor i këtij procesi është garantimi i transparencës dhe mbikëqyrjes së financiare, duke siguruar që BZH të operojë sipas standardeve më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me objektivat e saj të zhvillimit ekonomik. Për këtë arsye, do të zbatohen një sërë masash specifike që synojnë të rrisin nivelin e përgjegjshmërisë dhe të sigurojnë funksionimin efektiv të bankës.

Në këtë drejtim, ligji për krijimin dhe funksionimin e BZH-së do të përfshijë një mekanizëm të detajuar të raportimit dhe kontrollit, i cili do të garantojë një mbikëqyrje efektive nga institucionet përkatëse. Në përputhje me këtë kornizë, BZH do të jetë e detyruar të dorëzojë raporte vjetore pranë qeverisë dhe ndaj Kuvendit, me qëllim sigurimin e një mbikëqyrjeje më të gjerë institucionale dhe rritjen e transparencës së operacioneve të saj. Një tjetër element kyç i garantimit të transparencës është publikimi i pasqyrave financiare të bankës, duke krijuar një mekanizëm të hapur dhe të aksesueshëm për publikun dhe aktorët e interesuar. Ky detyrim ligjor do të sigurojë rritjen e besimit të investitorëve dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare, duke mundësuar një analizë më të thelluar të qëndrueshmërisë financiare të BZH-së dhe të ndikimit të saj në ekonominë vendase. Për të përforcuar më tej mekanizmat e mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të performancës financiare të bankës do të hartohen raporte tremujore të detajuara mbi aktivitetin e saj. Ky mekanizëm do të lehtësojë ndjekjen e ecures së institucionit dhe do të ndihmojë në identifikimin në kohë të problematikave që mund të kërkojnë ndërhyrje korrigjuese.

Përveç raportimeve të rregullta, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet auditimit dhe kontrollit të pavarur të operacioneve financiare të bankës. Për këtë qëllim, do të krijohen mekanizma specifike për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, të cilët do të sigurojnë përputhshmërinë e veprimtarisë së BZH-së me objektivat e saj strategjike dhe me praktikatat më të mira të qeverisjes financiare. Në këtë kuadër, do të vendosen detyrime të qarta për hartimin dhe publikimin e raporteve të auditimit, duke garantuar që banka të operojë në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurojë llogaridhënie të plotë ndaj institucioneve mbikëqyrëse dhe publikut të gjerë.

Përveç mekanizmave të brendshëm të mbikëqyrjes, përfshirja e aktorëve ndërkombëtarë dhe e sektorit privat në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të BZH-së do të jetë një faktor kyç për rritjen e besueshmërisë së këtij institucioni. Kjo do të mundësojë sigurimin e një vlerësimi të pavarur mbi performancën e bankës, duke forcuar ndërveprimin mes BZH-së dhe institucioneve financiare ndërkombëtare që do të kontribuojnë në kapitalizimin dhe zhvillimin e saj të mëtejshëm.

Matja e ndikimit të BZH-së në ekonomi do të bazohet në një sërë treguesish specifike, të cilët do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e ecures dhe efektivitetit të bankës në përmbushjen e misionit të saj zhvillimor. Treguesit kryesorë që do të përdoren për këtë qëllim përfshijnë:

- Numrin dhe vlerën e kredive të dhëna për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke vlerësuar shkallën e aksesit të tyre në financim përmes BZH-së.
- Përqindjen e financimeve të alokuara për sektorët strategjikë, përfshirë bujqësinë, turizmin dhe infrastrukturën, për të analizuar ndikimin e drejtpërdrejtë të bankës në zhvillimin ekonomik.
- Efikasitetin e përdorimit të kapitalit, duke matur raportin midis kapitalit të përdorur për investime dhe totalit të kapitalizimit të bankës.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela. Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kostoja për buxhetin – një herë	2500	2500	2500	2500						
Kostoja për buxhetin – në vazhdim										
Kostoja për biznesin – një herë										
Kostoja për biznesin – në vazhdim										
Kostoja për grupet e tjera – një herë										
Kostoja për grupet e tjera – në vazhdim										
Kostoja në total	2500	2500	2500	2500						
Kostoja e zbritur në total = Kostoja në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kostoja për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë. Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kostoja	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			